



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology

 INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

UDHËZUES PËR UDHËHEQJEN E ZBATIMIT TË KURRIKULËS NË SHKOLLË

Prishtinë, 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU MINISTRY
OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PËR UDHËHEQJEN E ZBATIMIT

TË KURRIKULËS NË SHKOLLA

Prishtinë, 2016

BOTUES

Instituti Pedagogjik i Kosovës

PËR BOTUESIN

Labëri Luzha

PËRGATITUR NGA

Spektori për Planifikim Mësimor në Institutin Pedagogjik të Kosovës

KONTRIBUES

Lindita Boshtrakaj

Selim Mehmeti

Shqipe Gashi-Ramadani

Drejtorë dhe Koordinatorë të shkollave pilot

Trajnerë në fushën e vlerësimit të performancës së shkollës

KORREKTOR GJUHËSOR

Sabit Jaha

Radhitja

Skender Mekolli

BALLINA

Gëzim Duzha

Shtypshkronja

“Blendi”

Dhjetor 2016

Botimi i dytë

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Mirënjohje.....	6
Qëllimi dhe funksioni i këtij udhëzuesi	7
Përmbledhje e përmbajtjes së udhëzuesit	8
Pjesa I: Pritshmëritë e reja nga shkolla.....	9
1. Parimet e Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar– parime të punës së shkollës.....	10
2. Roli i ri i shkollës: sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e kompetencave.....	14
3. Shtyllat e veprimtarisë së shkollës nga perspektiva e kërkesave të kurrikulës	15
3.2. Sigurimi i një mjedisi shkollor të sigurtë, të shëndetshëm dhe miqësor	19
3.3 Mësimdhënia dhe nxënia efektive	22
3.4 Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	25
3.5 Performanca e nxënësve	28
Pjesa II: Përgatitja për zbatimin e kurrikulës.....	31
1. Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit shkollor për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës	32
2. Analiza e kontekstit të përgjithshëm të shkollës	35
3. Vetëvlerësimi i performancës së shkollës në raport me pritshmëritë e kurrikulës së re.....	35
4. Përcaktimi i vizionit dhe misionit të përbashkët të shkollës.....	37
5. Përpilimi i planit zhvillimor të shkollës për zbatim të kurrikulës.....	37
6. Përpilimi i planit vjetor të veprimit për zbatimin e kurrikulës	39
7. Kalendar i mundshëm i aktiviteteve përgatitore të shkollës për zbatim të kurrikulës.....	43
Pjesa III: Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me bazë në shkollë.....	45
1. Mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës për planifikimin me bazë në shkollë.....	46
2. Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me bazë në shkollë	48
3. Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje.....	62
4. Format e planifikimit dhe organet përgjegjëse - përmbledhje tabelare	63
Pjesa IV: Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës.....	65
1. Realizimi i procesit mësimor në funksion të mësimi të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore.....	66
2. Përfshirja e prindërve në procesin mësimor.....	70
3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve dhe administrimi i rezultateve të vlerësimit.....	73

Pjesa V: Roli i udhëheqjes së shkollës në menaxhimin efektiv të procesit të zbatimit të kurrikulës	79
1. Roli i drejtorit të shkollës në zbatimin e kurrikulës	80
2. Roli i organeve tjera qeverisëse në zbatimin e kurrikulës.....	82
3. Roli i organeve profesionale të shkollës në zbatimin e kurrikulës.....	84
4. Roli i shërbimeve profesionale të shkollës.....	87
5. Roli i kordinatorit të cilësisë në shkollë	87
6. Organet tjera profesionale të shkollës	88
7. Hierarkia e përkrahjes, bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kurrikulës	89
Burimet:	90
Pjesa VI: Shtojcat	91

Hyrje

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me dokumentet e kurrikulës, Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar (2011 / e rishkuar në vitin 2016) dhe Kurrikulat Bërthamë (2012 / te rishkuara në vitin 2016), ka përcaktuar një shkallë më të lartë të autonomisë dhe përgjegjësisë së shkollës në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re, në përputhje me kërkesat dhe filozofinë e kurrikulës të bazuar në kompetenca, në përputhje me kuadrin mësimor, infrastrukturën e shkollës dhe karakteristikat e tjera të lokalitetit në të cilin gjendet shkolla.

Mbi bazën e dokumenteve të kurrikulës dhe Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 (PSAK), MASHT-i ka filluar procesin e pilotimit të kurrikulës së re. Fillimi i zbatimit të kurrikulës së re në shkollat pilotë, tregon për një nismë shumë serioze dhe me ndikim të rëndësishëm në të gjitha aspektet e punës së shkollës. Gjatë fazës së pilotimit të kurrikulës, është bërë progres në përfshirjen e shkollave brenda rolit të tyre të paraparë me kurrikulën e re dhe njëkohësisht janë identifikuar sfida dhe nevoja që duhet të adresohen para se të fillojë zbatimi i saj në të gjitha shkollat e Kosovës.

Për adresimin e sfidave dhe nevojave të dala gjatë procesit të pilotimit të kurrikulës dhe për të siguruar një qasje përgatitore të kujdesshme dhe të suksesshme në shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi, MASHT-i ka priorizuar një listë të masave që duhet ndërmarrë në përkrahje të këtij procesi në përgjithësi dhe në përkrahje të shkollave në veçanti. Në kuadër të masave për shtrirjen e zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi, paraqitet kërkesë e domosdoshme hartimi i një udhëzuesi për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkolla.

Për të përgatitur një udhëzues lidhur me orientimin e shkollave në një proces të drejtë të udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës, MASHT-i ftoi dhe autorizoi Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK) që ta udhëheqë punën në hartimin e këtij udhëzuesi. Përgatitja e udhëzuesit përfshiu një analizë të dokumenteve të kurrikulës së re, me theks të veçantë të rolit të shkollave në zbatimin e kurrikulës, një analizë të raporteve të shkollave nga pilotimi i kurrikulës, konsultime me zyrtarë të kurrikulave në MASHT, drejtorë të shkollave pilot, koordinatorë të kurrikulës në nivel qendror dhe në nivel shkolle, mësimdhënës dhe trajnerë të kurrikulës. Komentet, propozimet dhe rekomandimet e pranuar janë analizuar me kujdes dhe janë reflektuar në përmbajtjen dhe instrumentet e punës të përfshira në këtë udhëzues.

Duke besuar se ky udhëzues i plotëson nevojat e shkollave dhe do të jetë i dobishëm në procesin e përgjithshëm të udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës nga shkolla, ne i ftojmë shkollat që të marrin këtë udhëzues, dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe në frymën e tyre e të përvojave të avancuara të shkollës të fillojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re.

Mirënjohje

Ky udhëzues është përgatitur duke u bazuar në përvojën e shkollave pilot gjatë zbatimit të kurrikulës së re, respektivisht në vështirësitë e identifikuara gjatë monitorimit të procesit të zbatimit në këto shkolla nga IPK dhe MASHT- Divizioni i Kurrikulës.

Megjithatë, për t'u siguruar se jemi në drejtim të duhur sa i përket adresimit të nevojave konkrete të shkollave, në momente të caktuara, materiali është konsultuar me Drejtorë dhe Koordinatorë të shkollave pilot. Ky proces i konsultimit me shkollat pilot është koordinuar nga z. Skender Halimi, Koordinator për zbatim të kurrikulës në sh.f.m.u. Faik Konica.

Përpilimi i këtij Udhëzuesi ka përfituar edhe nga dy takime konsultative që janë realizuar për të diskutuar versionin e parë të materialit. Takimi i parë është realizuar me Drejtorë dhe Koordinatorë të shkollave pilot, përfshirë:

- Kumrije Sahiti, Drejtoreshë, Sh.F.M.U. "Faik Konica", Prishtinë
- Skender Halimi, Koordinator, Sh.F.M.U. "Faik Konica", Prishtinë
- Sherif Bajrami, Drejtor, Sh.F.M.U. "Arif Shala", Drenas
- Elhami Isufi, Koordinator, Sh.F.M.U. Arif Shala, Drenas
- Osman Beka, Drejtor, Gjimnazi "Sami Frashëri", Prishtinë
- Bislim Krasniqi, Koordinator, Gjimnazi "Sami Frashëri", Prishtinë
- Azem Jaha, Drejtor, Gjimnazi "Xhevdet Doda", Prishtinë
- Milazim Avdylaj, Koordinator, Sh.F.M.U. Abdyl Frashëri, Prizren
- Shpresa Shala, Drejtoreshë, Sh.F.M.U. Xhemajl Mustafa, Prishtinë
- Nexhat Rexha, Drejtor, Gjimnazi "Zenel Hajdini", Gjilan

Takimi i dytë është realizuar me një grup të trajnerëve në fushën e vlerësimit të performancës së shkollës, përfaqësues të udhëheqjes arsimore, përfaqësues të DKA-ve dhe shkollave, përfshirë:

1. Zana Zeqiri, Drejtoreshë, Sh.F.M.U. "Hilmi Rakovica", Prishtinë
2. Suzana Bytyqi, Mësimdhënëse, Gjimnaz, Drenas
3. Suzana Gjergji, DKA-Klinë
4. Liridon Maliqi, Drejtor, Sh.F.M.U. "MODEL"
5. Agron Mexhuani, Mësimdhënëse, Shkolla Amerikane e Kosovës, Prishtinë
6. Sadifete Lumi, IP Ardhmëria, Prishtinë
7. Lirije Vitija, Qendra Burimore "Përparimi", Prishtinë
8. Ajet Brajshori, Drejtor, Sh.M.T. "28 Nëntori", Prishtinë
9. Agim Blakqorri, DKA-Podujevë
10. Sherif Gashi, DKA- Suharekë

IPK falënderon të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuuesit në përpilimin e këtij materiali.

Qëllimi dhe funksioni i këtij udhëzuesi

Zbatimi i plotë i kurrikulës së re shtetërore, respektivisht i reformës në arsimin parauniversitar, arrihet vetëm kur:

- Mësimdhënësit e kuptojnë dhe pranojnë plotësisht frymën e re të kurrikulës dhe veprimtaritë e lidhura me zbatimin e saj kthehen në rutinë,
- Shkolla angazhohet vazhdimisht për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies drejt ngritjes së nivelit të arritjes së nxënësve,
- Shkollat dhe DKA-të angazhohen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, identifikimit të sfidave dhe gjetjes së zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të sistemit të ri të kurrikulës shtetërore,
- MASHT-i monitoron përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës në nivel shtetëror, si bazë për rishikimin dhe plotësimin e politikave programore në fushën e arsimit dhe për sigurimin e përkrahjes së nevojshme institucionale.

Roli i shkollës në këtë proces është vendimtar, prandaj, qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ndihmojë shkollën në udhëheqjen e procesit të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re shtetërore duke vendosur një agjendë të qartë për zhvillim të vazhdueshëm të praktikave të saj, në të mirë të përkrahjes së nxënësve drejt zotërimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore dhe drejt realizimit të potencialit të tyre. Për përmbushjen e këtij funksioni, udhëzuesi përqëndrohet në qartësimin e pritshmërive të reja nga shkolla dhe ofrimin e udhëzimeve konkrete për:

- planifikimin dhe udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës,
- sigurimin e një mjedisi mundësues për zbatimin e kurrikulës,
- planifikimin dhe realizimin e mësimin cilësor sipas kërkesave të reja të kurrikulës,
- zhvillimin profesional të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës,
- vetëvlerësimin e performancës së përgjithshme nga perspektiva e ndikimit në përmirësimin e arritshmërisë së nxënësve dhe
- përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në funksion të zbatimit të plotë të kërkesave të kurrikulës së re shtetërore

Përdorues të drejtpërdrejtë të këtij udhëzuesi do të jenë udhëheqja e shkollës, organet qeverisëse, organet profesionale dhe shërbimet profesionale të shkollës. Gjithsesi, materiali mund t'i shërbejë edhe MASHT-it dhe IPK-së në kuadër të përgatitjeve për zbatim të kurrikulës në mbarë vendin si dhe në planifikimin e mbështetjes dhe monitorimit të shkollave gjatë procesit të zbatimit.

Përmbledhje e përmbajtjes së udhëzuesit

Ky udhëzues është strukturuar në gjashtë pjesë. Në **Pjesën I** është dhënë konteksti i përgjithshëm rregullativ i veprimtarisë së shkollës, përfshirë (I) funksionin e parimeve të Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar në zbatimin e kurrikulës dhe ndikimin e tyre në punën e shkollës, (II) rolin e ri të shkollës dhe (III) fushat e cilësisë së performancës së shkollës. Në kuadër të fushave të cilësisë së performancës përshkruhet mbulueshmëria dhe specifikat e secilës fushë, pritshmëritë kryesore në kuadër të secilës fushë të veprimtarisë së shkollës dhe masat që duhen zbatuar nga shkolla (respektivisht nga akterët përgjegjës për secilën fushë të cilësisë).

Në **Pjesën II** elaborohen aktivitetet përgatitore që duhet të ndërmerren nga shkolla në kuadër të përgatitjeve për zbatimin e kurrikulës së re, me theks të vecantë në informimin e akterëve kryesorë me mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës, realizimin e një vlerësimi të brendshëm nën dritën e kërkesave të kurrikulës së re dhe përgatitjen e planit zhvillimor, sigurimin e një mjedisi mundësues për zbatimin e kurrikulës së re dhe funksionalizimin e organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës.

Në kuadër të pjesëve III dhe IV janë trajtuar proceset që preken drejtpërdrejtë nga qasja e re e kurrikulës dhe kërkojnë vëmendje të shtuar nga udhëheqja e shkollës¹.

Pjesa III fokusohet në aspektet e planifikimit të proceseve mësimore duke filluar nga planifikimi në nivel të shkollës kurrikulare e deri te planifikimi i orës mësimore. Roli i organeve profesionale të shkollës në nivelet e ndryshme të planifikimit është dhënë në formë tabelare në fund të kësaj pjese. Ndërsa, në **Pjesën IV** trajtohen aspektet e udhëheqjes së shkollës në raport me realizimin e proceseve mësimore, përfshirjen e prindërve, vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe administrimin e rezultateve të vlerësimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së proceseve mësimore dhe performancës së përgjithshme të shkollës.

Pjesa V trajton rolin e organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollës për zbatimin e kurrikulës së re.

Në **Pjesën VI** mund t'i gjeni disa mostra të instrumenteve për realizimin e proceseve që trajtohen në udhëzues.

¹ Çështjet tjera që kanë të bëjnë me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës identifikohen përmes vetëvlerësimit të shkollës dhe adresohen në kuadër të planit zhvillimor të shkollës.

Pjesa I: Pritshmëritë e reja nga shkolla

1. Parimet e Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar- parime të punës së shkollës

Me Kornizën e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar (KKAP), MASHT-i është përcaktuar për një qasje të bazuar në kompetenca, respektivisht qasje të orijentuar kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Për të siguruar koherencën dhe konsistencën e procesit të zbatimit të kësaj qasje, KKAP vendos pesë parime themelore:

- **Gjithëpërfshirja**, i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. *E udhëhequr nga ky parim shkolla mundëson qasje dhe përfshirje të barabartë të secilit nxënës, duke kontribuar në realizimin e plotë të potencialit individual të secilit fëmijë/të ri². Ky parim duhet të udhëheqë qasjen e shkollës ndaj komunitetit të shkollës dhe jashtë saj dhe veçanërisht ndaj fëmijëve që janë brenda e jashtë procesit mësimor.* Performanca e shkollës nuk vlerësohet vetëm në bazë të nivelit të arritshmërisë së nxënësve të cilët e vijnë shkollën por edhe në bazë të shkallës së përfshirjes së fëmijëve të lokalitetit në të cilin vepron.
- **Zhvillimi i kompetencave**, nënkupton arritjen e matshme të dijeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat shoqëria i konsideron të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Në sistemin e kurrikulës kompetencat kryesore zërthehen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, që duhet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit gjatë arsimit parauniversitar, respektivisht deri me rastin e përfundimit të klasës së 12-të. *Ky parim duhet të udhëheqë gjithë procesin e planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të punës së shkollës.*
- **Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar**, për të siguruar të nxënësve që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu, me dijen dhe informacionin që kemi për to. E udhëhequr nga ky parim shkolla duhet të mundësojë:
 - Planifikimin dhe realizimin e proceseve të integruara mësimore në kuadër të lëndëve që mbulojnë një fushë kurrikulare, drejt zotërimit të rezultateve të të nxënësve të përcaktuara për fushën përkatëse kurrikulare. P.sh. proceset mësimore që zhvillohen në kuadër të lëndës së gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera duhet të jenë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësve për fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi. Apo, në rastin e nivelit të mesëm të lartë-drejtimi i përgjithshëm, proceset mësimore që zhvillohen në kuadër të lëndës së fizikës, kimisë, biologjisë e kimisë duhet të jenë në

² Përfshirja në kuptim të qasjes fizike në të gjitha hapësirat e shkollës, përfshirjes në aktivitetet mësimore (kurrikulare dhe jashtëkurrikulare), përfshirjes në proceset vendimmarrëse të shkollës, etj.

funkcion të arritjes së rezultateve të të nxënit për fushën kurrikulare Shkencat e natyrës;

- Ndërlidhjen e fushave kurrikulare në funksion të një procesi të plotë dhe të shumanshëm mësimor që vë në pah ndërlidhjen e aspekteve të ndryshme të proceseve mësimore që trajtohen në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare;
- Ndërlidhjen kuptimplotë të mësimimit me jetën përmes (I) planifikimit të përmbajtjeve mësimore që reflektojnë preokupimet e nxënësve, të shoqërisë e të mjedisit në të cilin vepron shkolla dhe më gjerë, (II) shfrytëzimit të mjeteve, situatave dhe burimeve rrethore për realizimin e proceseve mësimore, (III) freskimit të vazhdueshëm të përmbajtjeve mësimore me përmbajtje që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës dhe (IV) realizimit të proceseve mësimore, që mundësojnë zbatimin e dijes dhe shfrytëzimin e shkathtësive, qëndrimeve e vlerave të caktuara në konteskt të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme.

- **Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle**, i mundëson shkollës të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor dhe infrastrukturës së saj dhe brenda kuadrit rregullativ të vendosur nga MASHT-i. Kjo do të thotë se *qasja e bazuar në kompetenca nënkupton mundësi të barabarta dhe jo barazim të mundësive*, prandaj, Korniza e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë kanë rritur autonominë e shkollës në organizim dhe zbatim të proceseve mësimore³.
- **Përgjegjësia dhe llogaridhënia**, nënkupton se procesi i decentralizimit të shërbimeve arsimore dhe rritja e autonomisë së shkollës, duhet të shoqërohet nga një mekanizëm funksional për sigurim të cilësisë dhe llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Sigurimi i cilësisë në arsim arrihet vetëm duke zhvilluar një kulturë të (vet) vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shkollës drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve.

Këto parime janë vendosur për të udhëhequr procesin e zbatimit të sistemit të ri të kurrikulës duke mundësuar:

- Zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollës dhe nivelit të arritjes së nxënësve;
- Përfshirje aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e proceseve mësimore, duke u vetëdijësuar që të vlerësojnë rëndësinë e përvojave të caktuara

³ Më shumë për shfrytëzimin e autonomisë dhe fleksibilitetit në nivel shkolle shih Pjesa III, Seksioni 1.

dhe duke u përgatitur që të vlerësojnë dhe vetëvlerësojnë rezultatet vetanake të të nxënësve;

- Vlerësim të njësuar të nivelit të arritjes së nxënësve dhe monitorim të cilësisë së arsimit që ofrohet në nivel vendi, komune apo shkolle;
- Promovim të mësimdhënies së integruar nëpërmjet fushave të gjera kurrikulare;
- Ndërlidhje kuptimplotë ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme;
- Perspektivë të mësimi gjatë gjithë jetës, duke u kushtuar vëmendje të veçantë mësimi për të nxënë dhe zhvillimit të kompetencave për shfrytëzim të teknologjive aktuale dhe të ardhshme të epokës digjitale;
- Ndërtim të një kulture të re organizative, zhvillimore dhe pedagogjike të shkollës përmes autonomisë dhe fleksibilitetit të shtuar të shkollës⁴
- Vendosje të një sistemi të qartë të përkrahjes, raportimit dhe llogaridhënies.


Prandaj:

Parimet e KKAP-së duhet të trajtohen në mënyrë tërësore duke pasur parasysh relacionin e ndërvarësisë mes tyre.

Duke pasur parasysh se qasja e bazuar në kompetenca përbën edhe filozofinë e kurrikulës së re shtetërore, çdo intervenim që planifikohet në nivel shkolle duhet të verifikohet nga perspektiva e kësaj qasjeje.

Pra, të gjitha iniciativat e shkollës që planifikohen dhe realizohen në nivel shkolle duhet të jenë në funksion të gjithëpërfshirjes dhe zhvillimit të kompetencave.

⁴ Përveç autonomisë, në hartimin e planeve dhe programeve mësimore me bazë në shkollë, shkollat kanë autonomi të konsiderueshme edhe në shpërndarjen e fondit të orëve për lëndë; Kurrikula bërthamë përcakton përqindjen minimale për secilën fushë mësimore / shkallë kurrikulare, përderisa fondi i orëve për lëndë / vit shkollor definohet në nivel shkolle.



Edhe roli i ri i shkollës është përcaktuar në bazë të parimeve të KKAP-së, prandaj këto parime përbëjnë fundamentin e sistemit për vlerësimin e performancës së shkollës. Ky sistem është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të (I) parimeve kryesore të KKAP-së dhe (II) fushave të cilësisë për vlerësimin e performancës së shkollës⁵.

Mbi këtë bazë:

Parimet e KKAP-së duhet të shërbejnë si fundament dhe pika reference gjatë planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të iniciativave që ndërmerren në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re shtetërore... kjo nënkupton që të gjitha iniciativat dhe masat që planifikohen dhe realizohen në nivel shkolle duhet të jenë në përputhje me parimet kryesore të KKAP-së.

⁵ Parimet e KKAP-së përbëjnë fundamentin e sistemit të vlerave të Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, ndërsa fushat e cilësisë i japin strukturën e ndërlidhjen vertikale për vlerësimin e gjendjes dhe për planifikimin e përmirësimit. Pikërisht në ndërveprimin në mes të Parimeve të KKAP dhe fushave të cilësisë janë krijuar kriteret bazë për vlerësimin e performancës së shkollës. Për më tepër shih: Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës.

2. Roli i ri i shkollës: sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e kompetencave

Sipas Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës⁶ *detyrë thelbësore e çdo shkolle në Republikën e Kosovës është të sigurojë zotërimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore nga të gjithë nxënësit, në një mjedis të sigurt, përfshirës, miqësor dhe inkurajues për gjithë komunitetin shkollor*⁷.

Nga ana tjetër, autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle i mundësojnë shkollës të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron. Kjo nënkupton se çdo shkollë ka mundësi që organizimin e proceseve mësimore ta përshtasë me veçoritë e nxënësve të saj dhe të komunitetit në të cilin vepron, prandaj:

një shkollë e mirë konsiderohet ajo shkollë e cila, brenda autonomisë dhe fleksibilitetit të lejuar, shfrytëzon në mënyrë efektive kapacitetin që ka në dispozicion për ndërtimin e profilit të vet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve të saj dhe në të mirë të avancimit të lokalitetit në të cilin vepron.

Për të arritur këtë qëllim çdo shkollë duhet të ketë një vizion të qartë, të ndërtuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të njohur dhe të pranuar nga gjithë komuniteti i shkollës, i cili reflekton nevojat specifike të nxënësve të saj dhe lokalitetit ku vepron.

Prandaj, për të përmbushur funksionin e saj themelor nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër për të qenë në shërbim të nxënësve të saj dhe komunitetit në të cilin vepron, çdo shkollë duhet të vendosë:

- mekanizëm efektiv të vetëvlerësimit në raport me kriteret e cilësisë së performancës së shkollës, të përcaktuara nga MASHT-i dhe në raport me vizionin e saj;
- mekanizëm dhe procedura të qarta të planifikimit zhvillimor me pjesëmarrje të gjerë;
- agjendë të qartë dhe përkushtim për zhvillim të vazhdueshëm të praktikave të saj, në të mirë të përkrahjes së nxënësve drejt zotërimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore dhe drejt zhvillimit të potencialit të tyre.

Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë më të detajuar në pjesët vijuese të këtij doracak.

⁶ Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës përcakton pritshmëritë themelore për çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës dhe është pikë referimi për (I) sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe për (II) standardizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm, planifikimit zhvillimor të shkollës dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës.

⁷ Udhëheqja e shkollës, mësimmhënësit, nxënësit, prindërit, ekipet profesionale, administrata e shkollës si dhe personeli teknik.

3. Shtyllat e veprimtarisë së shkollës nga perspektiva e kërkesave të kurrikulës

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, respektivisht pesë shtylla të veprimtarisë së shkollës. Këto pesë fusha janë: (I) Menaxhimi dhe qeverisja, (II) Kultura dhe mjedisi, (III) Mësimdhënia dhe nxënia, (IV) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe (V) Performanca e nxënësve.

Më poshtë është përshkruar shkurtimisht mbulueshmëria dhe specifikat e secilës fushë, si dhe kriteret e cilësisë që duhen pasur parasysh nga menaxhmenti i shkollës në kuadër të secilës shtyllë të veprimtarisë së shkollës. Kriteret e cilësisë janë përcaktuar bazuar në ndërveprimin në mes të fushave të cilësisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar në Kosovë.

Secila fushë e cilësisë ka nga pesë kritere. Këto kritere burojnë nga pesë parimet e kurrikulës duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës.

Mbi këtë bazë është ndërtuar edhe tabela e Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës. Kjo kornizë shërben si orientim për zbatimin e kurrikulës së re shtetërore dhe si referencë për vlerësimin e performancës së shkollës.

Korniza e kriterëve të cilësisë së performancës së shkollës

PARIMET E KKAP	FUSHAT E CILËSISË				
	1 MENAXHIMI DHE QEVERISJA	2 KULTURA DHE MJEDISI	3 MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	5 PERFORMANCA E NXËNËSVE
	KRITERET E CILËSISË				
GJITHËPËRFSHIRJA	1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	2.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore	3.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore	4.1 Menaxhmenti i shkollës përfshin nxënësit, prindërit dhe mësime të planifikimin e ZhPM	5.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet
ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE	1.2 Shkolla ka në fokus të orjentimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve	2.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave	3.2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit	4.2 Praktikrat e zhvillimit profesional të mësime të nxënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve	5.2 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmëritë e vendosura me KB
MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA E INTEGRUAR	1.3 Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar	2.3 Mjedis dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimin të kurrikulës	3.3 Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar	4.3 Praktikrat e zhvillimit profesional të mësime të nxënësve janë në funksion të mësime të integruar	5.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmëritë e vendosura me KB
AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITETI	1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetvlerësimit	2.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik	3.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive	4.4 Shkolla përdorë në mënyrë efektive resurset e saj për aktivitetet e ZhPM	5.4 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstrakurrikulare
PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNI	1.5 Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore	2.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënësve	3.5 Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësime të nxënësve	4.5 Shkolla mbikqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësime të nxënësve	5.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetanë

3.1. Menaxhimi dhe qeverisja efektive në përmbushjen e funksionit të shkollës

Rritja e autonomisë shkollë, përgjegjësisë dhe shkallës së llogaridhënies për performancën e shkollës e të nxënësve ka sjellur edhe ndryshimin e rolit, misionit dhe përgjegjësi të udhëheqjes dhe menaxhimit të shkollave.

Menaxhmenti i shkollës nuk shihet më si zbatues i urdhërave lart-poshtë por si strukturë vendimmarrëse që duhet të përqendrohet në proceset e udhëheqjes, qeverisjes, mësimdhënies e nxënies, si dhe në rezultatet mësimore të shkollës përmes një procesi gjithëpërfshirës.

Rrjedhimisht, fushëveprimi i udhëheqjes së shkollës duhet të ketë në fokus mësimin dhe të nxënësve, ndërsa qasja në zbatim duhet të jetë gjithëpërfshirëse.

Në këtë kontekst, personeli udhëheqës i shkollës është përgjegjës për performancën arsimore të shkollës, për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe për avancimin e arritshmërisë së nxënësve.

Në vijim është dhënë një përshkrim i shkurtër i secilës fushë të cilësisë dhe pritshmëritë nga menaxhmenti dhe personeli tjetër i shkollës.

Kriteret e cilësisë	Përshkrimi i kriterëve	Çka pritet nga udhëheqja e shkollës?
Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	<p>Udhëheqja e shkollës duhet të bashkëpunojë me nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe partnerët tjerë për të zhvilluar dhe formësuar një vizion të përbashkët.</p> <p>Gjithë komuniteti shkollor duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ t'i ketë të qarta qëllimet dhe prioritetet e shkollës si dhe ndikimin e këtyre qëllimeve në praktikën shkollë ▪ ta ketë të qartë pjesën e vet të përgjegjësisë në arritjen e qëllimeve dhe përmbushjen e prioriteteve të shkollës. <p>Nxënësit dhe prindërit duhet të ndjehen të vlerësuar dhe të kenë mundësi të përshtatshme për të shprehur qëndrimet e tyre të cilat mirren</p>	<p>Informimi dhe sensibilizimi i akterëve kryesorë në shkollë me kërkesat e reja dhe mundësitë që ofron kurrikula</p> <p>Funksionalizimi i organeve qeverisëse të shkollës</p> <p>Vendosja e procedurave të përfshirjes së prindërve në vendimmarrje dhe procedurave për ankesat e prindërve të cilat duhet të jenë funksionale dhe të qarta për prindërit.</p> <p>Vendosja e mekanizmave efektiv të komunikimit dhe konsultimit të vazhdueshëm me prindër.</p>

<p>Shkolla ka në fokus të orijentimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve</p>	<p>parasysh në proceset vendimmarrëse të shkollës.</p> <p>Cikli dhe procedurat e vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor duhet të jenë të qarta për gjithë komunitetin shkollor.</p> <p>Përmirësimi i vazhdueshëm, suksesi dhe arritjet e nxënësve duhet të jenë në fokus të orientimit strategjik të shkollës, prandaj, ngritja e cilësisë së nxënies duhet të jetë bosht i planeve zhvillimore të shkollës.</p> <p>Prioritetet e përcaktuara në planin zhvillimor të shkollës duhet të kenë ndikim të matshëm në arritjet, vijueshmërinë dhe mirëqenien e nxënësve.</p>	<p>Vendosja e një sistemi efektiv të administrimit të rezultateve të vlerësimit të nxënësve në të gjitha nivelet</p> <p>Shfrytëzimi i rezultateve të vlerësimit për të përcjellë trendin e arritshmërisë së nxënësve në nivel shkollë dhe për të avancuar proceset e mësimdhënies dhe punës së përgjithshme të shkollës.</p> <p>Rishikimi i strukturave të menaxhimit, nxënies dhe përkrahjes së nxënësve nga perspektiva e efikasitetit të funksionimit të tyre dhe impaktit në ngritjen e cilësisë.</p>
<p>Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar</p>	<p>Kompetencat kryesore të përcaktuara me KKAP dhe kurrikulat bërthamë janë kryesisht të natyrës ndërkurrikulare dhe nuk mund të zhvillohen përmes një qasje të fragmentuar. Prandaj, funksionalizimi i mekanizmave për jetësimin e mësimit të integruar është i domosdoshëm.</p> <p>Organet profesionale të shkollës duhet të funksionojnë si menaxhmenti i mesëm në shkollë dhe duhet të kenë procedura të qarta të veprimit dhe llogaridhënies.</p>	<p>Funksionalizimi i organeve profesionale të shkollës</p>
<p>Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë</p>	<p>Tërë puna e shkollës duhet të udhëhiqet nga vizioni, vlerat dhe qëllimet e vendosura të shkollës.</p>	<p>Vendosja dhe konsolidimi i shërbimeve profesionale të shkollës</p>

<p>vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vet-vlerësimit</p>	<p>Vizioni i shkollës duhet të bazohet në rezultatet e nxënësve, nevojat e tyre dhe duhet të jetë në përputhje me prioritetet e komunitetit dhe të politikave arsimore. Ai duhet të jetë koherent në raport me atë që është e rëndësishme për nxënësit dhe komunitetin.</p> <p>Shkolla duhet të dëshmojë përkushtimin e saj ndaj cilësisë dhe vazhdimisht t'u rikthehet vlerave dhe qëllimeve të saj duke fuqizuar ndjenjën e përbashkët të përgjegjësisë për arritjen e tyre.</p>	<p>Realizimi i një analize të kontekstit të përgjithshëm të shkollës</p> <p>Përcaktimi i vizionit dhe misionit të përbashkët, mbi bazën e analizës së kontekstit në të cilin vepron shkolla.</p> <p>Jetësimi i vizionit dhe misionit të përbashkët.</p>
<p>Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore</p>	<p>Personeli udhëheqës i shkollës është përgjegjës për performancën arsimore të shkollës, për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe për avancimin e arritshmërisë së nxënësve. Përkëtë qëllim udhëheqja e shkollës duhet të vendosë një agjendë të qartë të procesit të zbatimit të kurrikulës dhe avancimit të vazhdueshëm të praktikës shkollë si dhe të udhëheqë zbatimin e kësaj agjende.</p> <p>Udhëheqja e shkollës dhe shërbimi profesional duhet të sigurojnë mbështetjen e nevojshme dhe të mbikqyrin procesin e realizimit të PZhSh. Shkolla duhet të realizoj vlerësime periodike të zbatimit dhe t'i përgatis raportet përkatëse.</p>	<p>Realizimi i një vlerësimi të brendshëm të situatës së shkollës në dritën e kërkesave të kurrikulës</p> <p>Përpilimi i planit trevjeçar zhvillimor të shkollës.</p> <p>Zbatimi i PZhSh.</p>

3.2. Sigurimi i një mjedisi shkollor të sigurtë, të shëndetshëm dhe miqësor

Mjedisi mundësues (atraktiv, miqësor dhe i shëndetshëm) fizik dhe shpirtëror është parakusht themelor për të realizuar të nxënësit efektiv dhe të qëndrueshëm të nxënësve.

Autoritetet arsimore, komuniteti, menaxhmenti i shkollës dhe mësimdhënësit duhet të sigurojnë një mjedis mundësues për realizimin e misionit kryesor të shkollës në Kosovë -zhvillimin tërësor të kompetencave të nxënësve në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

Në vijim është dhënë një përshkrim i shkurtër i secilit kriter dhe pritshmëritë nga menaxhmenti i shkollës për përmbushjen e tyre.

Kriteret e cilësisë	ÇPërshkrimi i kriterëve	Çka pritët nga udhëheqja e shkollës?
<p>Objekti dhe hapësirat tjera të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore</p>	<p>Objekti i shkollës, përfshirë oborrin dhe hapësirat rreth shkollës duhet të mundësojnë qasje dhe lëvizje të lirë për të gjithë nxënësit, të jenë të sigurta, të këndshme dhe stimuluese për nxënie, aktivitete sociale dhe rekreative.</p> <p>Marrëdhëniet ndërnjerëzore në të gjitha nivelet janë pozitive dhe bazohen në një klimë të respektit reciprok dhe vetërespektit. Personeli shkollor duhet të ndjehet i vlerësuar, i konsultuar dhe i përkrahur për të ofruar një arsim cilësor; qëndrimet dhe shkathtësitë e tyre individuale dhe ekipore duhet t'i ndikojnë proceset e përmirësimit të cilësisë dhe punës së shkollës.</p>	<p>Sigurimi i qasjes, lëvizjes së lirë dhe të sigurt për të gjithë nxënësit.</p> <p>Sigurimi i një mjedisi fizik të pastër, të këndshëm dhe stimulues për nxënie, aktivitete sociale dhe rekreative.</p> <p>Kultivimi i një klime miqësore dhe inkurajuese për gjithë komunitetin shkollor.</p>
<p>Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave</p>	<p>Shkolla duhet të udhëhiqet nga vetëdija dhe besimi se secili nxënës mund të mësojë dhe të përparojë. Niveli i pritshmërive të shkollës për zotërimin e kompetencave, për arritjet akademike dhe për realizimin e individual të secilit nxënës duhet të jetë i lartë.</p> <p>Shkolla duhet të angazhohet për identifikimin e faktorëve të cilët mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.</p> <p>Përmes punës së afërt me nxënës, me prindërit dhe me ofruesit tjerë të shërbimeve (jashtë shkolle) shkolla duhet t'i adresoj faktorët të cilët pengojnë qasjen vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.</p>	<p>Vendosja e procedurave të qarta për identifikimin e faktorëve të cilët pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.</p> <p>Ndërtimi i rrjeteve të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike me qëllim të përkrahjes së fëmijëve dhe familjeve të tyre në eliminimin e barrierave ⁸ të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.</p>

⁸ Barrierat të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollës mund të jenë problemet sociale në familje (duke filluar nga paaftësia apo pamundësia e prindërve për përkrahjen e fëmijëve të tyre e deri te rastet e dhunës dhe keqtrajtimit të tyre) apo vështirësitë ekonomike.

<p>Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës</p>	<p>Burimet mësimore duhet të jenë të mjaftueshme për të mundësuar realizimin e proceseve mësimore sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulat bërthamë. Ato duhet të organizohen mirë, të jenë të qasshme, të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme për të përmbushur nevojat e nxënësve.</p> <p>Nxënësit duhet të inkurajohen për shfrytëzim të pavarur dhe të përgjegjshëm të burimeve me të cilat disponon shkolla. Mësimdhënia dhe nxënia duhet të pasurohen me shfrytëzimin e TIK, mjedisit përreth dhe burimeve të tjera jashtë shkolle.</p>	<p>Sigurimi i burimeve për realizimin e proceseve mësimore</p> <p>Planifikimi i hapësirave të shkollës</p>
<p>Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik</p>	<p>Shkolla duhet të bashkëpunoj me prindërit dhe komunitetin në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik të shkollës.</p> <p>Ajo duhet të shfrytëzoj qasje të ndryshme edhe për të raportuar dhe për të shënuar kontributin individual e grupor të nxënësve e mësimdhënësve, prindërve e komunitetit shkollor.</p>	<p>Vendosja e partneritetit me prindër e palë të tjera në komunitet me qëllim të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit fizik të shkollës.</p>
<p>Shkolla ofron një mjedis të sigurtë dhe mundësues për realizim të të nxënies efektive</p>	<p>Aspektet e sigurisë dhe shëndetit duhet të identifikohen dhe adresohen me kohë, ndërsa higjiena të jetë në nivel të lartë.</p> <p>Gjithë personeli i shkollës duhet të jetë në dijeni për të drejtat, përgjegjësitë dhe kodin e sjelljes.</p>	<p>Vendosja e mekanizmave për t'u marrë me rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare (apo me situata të tjera të rrezikut të përgjithshëm)</p> <p>Përpilimi i standardeve të sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies.</p> <p>Definimi i përgjegjësive për sigurinë, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objektit shkollor, hapësirave përreth dhe burimeve mësimore.</p>

3.3 Mësimdhënia dhe nxënia efektive

Tendencat arsimore të viteteve të fundit në Kosovë i karakterizon lëvizja prej aktiviteteve që në fokus kanë mësimdhënien në drejtim të mësimdhënies, ku nxënësi është në qendër të proceseve arsimore në shkollë.

Prandaj,

proceset mësimore në shkollë duhet të karakterizohen nga pjesëmarrja aktive e secilit nxënës, duke i bërë ata pjesë të diskutimeve se si të mësojnë dhe si të përmirësohen...qëllimi i proceseve mësimore duhet t'u komunikohet qartë nxënësve dhe ata duhet të jenë të vetdijshëm për arsyeshmërinë e çdo aktiviteti në të cilin marrin pjesë dhe për përgjegjësinë e tyre për përmirësim dhe sukses.

Po ashtu,

përmbajtjet dhe përvojat mësimore duhet të jenë në funksion të qasjes së integruar, të jenë sfiduese dhe të reflektojnë nevojat, interesimet dhe mundësitë e secilit nxënës.

Në vijim është dhënë një përshkrim i shkurtër i kritereve të cilësisë dhe pritshmërive nga udhëheqja e shkollës dhe personeli mësimor në kuadër të kësaj fushe të cilësisë.

Kriteret e cilësisë	Përshkrimi i kritereve	Çka pritet nga udhëheqja e shkollës dhe kuadri mësimor?
Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore	<p>Aktivitetet mësimore në shkollë duhet të karakterizohen nga pjesëmarrja aktive e secilit nxënës, duke i bërë nxënësit pjesë të diskutimeve se si të mësojnë dhe si të përmirësohen. Qëllimi i proceseve mësimore duhet t'u komunikohet qartë nxënësve, duke i bërë ata të vetdijshëm për arsyeshmërinë e çdo aktiviteti në të cilin marrin pjesë dhe për përgjegjësinë e tyre për përmirësim dhe sukses.</p> <p>Detyrat dhe aktivitetet mësimore duhet të jenë në përputhje me nevojat e nxënësve individualë dhe grupeve me interesa të përbashkëta.</p> <p>Prindërit duhet të mbahen të informuar për arritshmërinë e fëmijëve të tyre, zhvillimin dhe progresin. Ata duhet të kenë</p>	<p>Përfshirja e nxënësve në proceset mësimore</p> <p>Përfshirja e prindërve në proceset mësimore</p>

Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit të tyre	<p>mundësi për të kontribuar në të nxënit dhe progresin e fëmijëve të tyre.</p>	
	<p>Nxënësit duhet të vëzhgohen në situata të ndryshme (jo vetëm gjatë procesit mësimor) dhe në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimi cilësor, respektivisht informatat kthyesë që marrin për procesin e nxënies së tyre duhet t'i vetëdijësojnë nxënësit për progresin dhe potencialin e tyre si nxënës.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit, reflektimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve për efektivitetin e proceseve mësimore dhe informatat kthyesë të nxënësve shfrytëzohen për të planifikuar dhe përshtatur aktivitetet mësimore. Format e ndryshme të përkrahjes së diferencuar duhet t'u mundësojnë nxënësve të maksimizojnë progresin e tyre duke u bazuar në stilet individuale të të nxënit, në informacionet dhe përvojat paraprake të nxënësve si dhe duke ndërtuar mbi pikat e forta të secilit nxënës. Përvojat shkollore duhet t'i inspirojnë nxënësit të kuptojnë se si mësimi i ndihmon ata në arritjen e qëllimeve të tyre.</p> <p>Mësimdhënësit duhet të ofrojnë mundësi për punë të përbashkët/ekipore të nxënësve, t'i inkurajojnë ata që të hulumtojnë dhe t'i sfidojnë gjërat që i mësojnë si dhe t'i përkrahin që t'i kultivojnë vlerat e një shoqërie demokratike.</p>	<p>Përkrahja e individualizuar e nxënësve gjatë aktiviteteve mësimore</p> <p>Vlerësimi për të nxënë</p>
	<p>Përmbajtjet dhe proceset mësimore janë në funksion të qasjes së integruar</p>	<p>Përmes punës së afërt me nxënës, mësimdhënësi duhet të identifikojë, vlerësojë dhe përmbush nevojat e ndryshme të nxënësve për nxënie.</p> <p>Përmbajtjet dhe përvojat mësimore duhet të jenë në funksion të qasjes së integruar, të jenë sfiduese dhe të reflektojnë nevojat, interesimet dhe mundësitë e secilit nxënës.</p>
Autonomia për	<p>Fleksibiliteti për planifikimin dhe realizimin e kohës shkollore duhet të</p>	<p>Planifikimi për shkallë kurrikulare</p>

⁹ Shih Pjesa III e këtij doracak, seksioni 1.

<p>planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive</p>	<p>shfrytëzohet për të mundësuar mësim dhënie të integruar dhe interaktive.</p> <p>Pjesa me zgjedhje e kurrikulës duhet të jetë në funksion të zbatimit të elementeve plotësuese kurrikulare në mënyrë që të përmbushen nevojat e veçanta të nxënësve, të cilat janë rrjedhojë e rrethanave dhe veçorive të komunitetit në të cilin shkolla vepron.</p> <p>Detyrat e personelit mësimor duhet të përcaktohen duke u bazuar në një analizë të kujdesshme dhe të dokumentuar të përparësive dhe dobësive të secilit mësimdhënës; roli i mësimdhënësit nuk kufizohet vetëm në realizimin e procesit mësimor gjatë orëve mësimore, por përfshin edhe (I) zhvillimin e mësimin plotësues, (II) zhvillimin e mësimin shtues, (III) zhvillimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare, (IV) udhëheqjen e organeve profesionale të shkollës, (V) mentorimin dhe shkëmbimin kolegjial të përvojave të mësimdhënies, etj.</p>	<p>Zhvillimi i programeve mësimore</p> <p>Planifikimi periodik dhe javor i proceseve mësimore</p> <p>Planifikimi dhe jetësimi i kurrikulës me bazë në shkollë</p> <p>Planifikimi i personelit mësimor në përputhje me profilin e tyre profesional e personal.</p>
<p>Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve</p>	<p>Rishikimi dhe freskimi i kurrikulës me bazë në shkollë (përmbajtja, shpërndarja e orëve, organizimi, kurrikula me zgjedhje) duhet të jetë pjesë e një procesi të vazhdueshëm të shkollës me pjesëmarrje të gjithë personelit mësimor dhe udhëheqës, duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit përfundimtar dhe duke marrë në konsideratë qëndrimet e nxënësve dhe prindërve.</p> <p>Shkolla vazhdimisht duhet të reflektojë për cilësinë dhe efektivitetin e përvojave të mësimdhënies dhe nxënies në raport me zbatimin e kërkesave të kurrikulës shtetërore dhe përmbushjen e misionit të saj. Mbi këtë bazë ajo është e angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies dhe nxënies drejt një arritshmërie të lartë të nxënësve.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i përvojave të mësimdhënies dhe të nxënësve</p>

3.4 . Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Institucionet shkollore e kanë në thelb të vetin përcjelljen e trendeve më të reja arsimore, pedagogjike, teknologjike e shoqërore. Ato duhet të mbajnë hapin me arritjet më të reja në fushën e dijes, shkencës e teknologjisë për avancimin e përvojave të nxënies (si në kuptimin e përmbajtjes, ashtu dhe në metodologjinë e zhvillimit të të nxënies). Shkolla njëkohësisht duhet të sigurojë që mësimitdhënësit të përcjellin edhe trendet e shkencës së pedagogjisë, psikologjisë, shkencave sociale e të tjera por edhe të reflektojnë vazhdimisht për efektivitetin e performancës së tyre në raport me arritjen e pritshmërive të përcaktuara me kurrikulat bërthamë dhe në raport me performancën e nxënësve.

Prandaj,

zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të planifikohet me kujdes dhe të reflektojë nevojat individuale të mësimitdhënësve dhe nevojat e shkollës për avancim të praktikave të mësimitdhënies dhe përmirësim të arritshmërisë së nxënësve. .. plani i shkollës për zhvillim profesional duhet të jetë në funksion të plotë të realizimit të politikave shtetërore arsimore dhe misionit të shkollës.

Për këtë qëllim,

shkolla duhet të konsolidoj një praktikë të vetëreflektimit të vazhdueshëm të mësimitdhënësve mbi cilësinë e praktikave mësimore dhe identifikimin e faktorëve që rrezikojnë cilësinë e mësimitdhënies....reflektimi kolegjial duhet të jetë pjesë e forumeve të ndryshme të mësimitdhënësve, si në kuadër të organeve profesionale ashtu edhe përmes formave të tjera të ndërveprimit mes tyre.

Planifikimi i zhvillimit profesional të mësimitdhënësve fillimisht duhet të absorbojë të gjitha mundësitë që janë në dispozicion brenda shkollës (mentorimi kolegjial, format e ndryshme të shkëmbimit të përvojave të mira dhe ekspertizës ndërmjet mësimitdhënësve, zhvillimi profesional nga ekipet profesionale të shkollës) për të vazhduar pastaj me format tjera jashtë shkollës, përfshirë: shkëmbimin e përvojave me shkollat tjera dhe organizimin e programeve të zhvillimit profesional në bashkëpunim me ofertues të këtyre shërbimeve.

Nga ana tjetër, organet udhëheqëse, shërbimet profesionale të shkollës por edhe vetë mësimitdhënësit duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë ndikimin e zhvillimit profesional në planifikimin dhe realizimin e proceseve mësimore, duke i shfrytëzuar këto gjetje për planifikimin e mëtejshëm të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve.

Në kuadër të planit për zhvillim profesional të mësimitdhënësve (ZhPM) udhëheqja e shkollës dhe shërbimet profesionale fillimisht duhet t'i absorbojnë të gjitha mundësitë e ZhPM me kapacitetin që ka në dispozicion, përfshirë:

- Shkëmbimin e përvojave të mira ndërmjet mësimitdhënësve (përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë të përvojave të mira, mentorimit kolegjial, reflektimit të vazhdueshëm kolegjial në takimet e rregullta në kuadër të organeve profesionale apo në kuadër të bashkëpunimit për planifikimin dhe për realizimin e aktiviteteve mësimore, etj.)
- Planifikimin e punëtorive duke shfrytëzuar si persona burimor (I) mësimitdhënësit e trajnuar për trajner, (II) mësimitdhënësit që kanë vijuar programe të ndryshme trajnimi dhe praktikojnë me sukses metoda të punës që janë në funksion të zbatimit të kurrikulës së re, (III) personelin që është i angazhuar për shërbime profesionale të shkollës, etj.
- Shkëmbimin e përvojave me shkollat tjera, etj.

Në vijim është dhënë një përshkrim i shkurtër i secilit kriter dhe pritshmëritë nga udhëheqja e shkollës dhe personeli mësimor për përmbushjen e tyre.

Kriteret e cilësisë	Përshkrimi i kriterëve	Çka pritet nga udhëheqja e shkollës dhe kuadri mësimor?
Menaxhmenti i shkollës përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimitdhënësit në planifikimin e ZhPM	<p>Personeli shkollor duhet të jetë në dijeni për qëllimet dhe prioritetet e shkollës për zhvillim profesional dhe ndërlidhjen e këtij procesi me përmirësimin e performancës së shkollës.</p> <p>Nevojat individuale të mësimitdhënësve duhet të identifikohen dhe evidentohen nga vetë mësimitdhënësit, nga kolegët e tyre dhe përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së tyre nga udhëheqja e shkollës.</p> <p>Perceptimi i proceseve mësimore dhe performancës së mësimitdhënësve nga nxënësit dhe prindërit është një aspekt tjetër i rëndësishëm i vlerësimit të nevojave të mësimitdhënësve për ZhPM.</p>	<p>Përfshirja e mësimitdhënësve në identifikimin e nevojave për ZhPM dhe për planifikimin e ZhPM.</p> <p>Përfshirja e nxënësve dhe prindërve në identifikimin e nevojave për ZhPM¹⁰.</p>

¹⁰ Mendimi i nxënësve dhe prindërve për performancën e mësimitdhënësve është shumë i rëndësishëm për identifikimin e anëve të forta dhe të dobëta të mësimitdhënësve, prandaj shërbimi profesional dhe menaxhmenti i shkollës mund të aplikojnë anketa apo teknika të tjera me nxënës dhe prindër për të marrë opinionin e tyre mbi performancën e mësimitdhënësve.

<p>Praktikat e zhvillimit profesional të mësimit janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve</p>	<p>Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore duhet të shfrytëzohen për planifikimin e ZhPM me bazë në shkollë.</p>	<p>Shfrytëzimi i rezultateve të arritshmërisë së nxënësve për planifikimin e ZhPM me bazë në shkollë.</p> <p>Monitorimi i ndikimit të ZhPM në ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit të mësimit për zhvillimin e kompetencave kryesore</p>
<p>Praktikat e zhvillimit profesional të mësimit janë në funksion të mësimit të integruar</p>	<p>ZhPM duhet t'i pasqyroj mangësitë e evidentuara të performancës së mësimit dhe organeve profesionale të shkollës në planifikimin dhe realizimin e mësimit të integruar</p>	<p>Monitorimi i ndikimit të ZhPM në ngritjen e kapacitetit të mësimit për planifikimin dhe realizimin e mësimit të integruar</p>
<p>Shkolla përdorë në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM</p>	<p>Shkolla duhet të konsolidojë një praktikë të vetëreflektimit të vazhdueshëm të mësimit mbi cilësinë e praktikave mësimore dhe identifikimit të faktorëve që rrezikojnë cilësinë e mësimit. Reflektimi kolegjial duhet të jetë pjesë e forumeve të ndryshme të mësimit, edhe në kuadër të organeve profesionale edhe përmes formave të tjera të ndërveprimit mes tyre.</p>	<p>Planifikimi dhe realizimi i zhvillimit profesional të mësimit duke identifikuar dhe shfrytëzuar fillimisht të gjitha mundësitë dhe resurset që janë në dispozicion brenda shkollës</p>
<p>Shkolla mbikqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimit</p>	<p>Plani i shkollës për zhvillim profesional duhet të jetë në funksion të plotë të realizimit të politikave shtetërore arsimore dhe misionit të shkollës.</p> <p>Zhvillimi profesional i mësimit duhet të adresojë nevojat individuale të mësimit dhe nevojat e shkollës për avancim të praktikave të mësimit dhe përmirësim të arritshmërisë së nxënësve.</p> <p>Menaxhmenti i shkollës dhe shërbimi profesional duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë ndikimin e zhvillimit profesional në planifikimin dhe realizimin e proceseve mësimore dhe t'i shfrytëzojnë këto gjetje për planifikimin e mëtejshëm të zhvillimit profesional të mësimit.</p>	<p>Identifikimi i faktorëve që rrezikojnë cilësinë e mësimit si bazë për planifikimin e ZhPM me bazë në shkollë.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të zhvillimit profesional në ngritjen e cilësisë së mësimit dhe nxënësve.</p>

3.5 Performanca e nxënësve


Shkolla ekziston për të zhvilluar kompetencat e nxënësve. Kompetencat në KKAP definoohen si tërësi e dijeve, shkathtësive dhe vlerave e përgjegjësive të zhvilluara tek nxënësit gjatë kohës së shkollimit. Kurrikulat bërthamë përcaktojnë qartë nivelin e kompetencave që duhen zotëruar nga të gjithë nxënësit në fund të secilës shkallë kurrikulare. Shkolla duhet të zhvillojë performancën e nxënësve në këto aspekte kryesore të kompetencave sipas shkallëve kurrikulare dhe niveleve të arsimit.

Kriteret e cilësisë në kuadër të kësaj fushe përqendrohen në:

- praktikat e përfshirjes së nxënësve në proceset e shkollës, si formë e manifestimit të kompetencës për të ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si pjesë e institucionit arsimor;
- arritshmërinë dhe progresin e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore (RNSh);
- progresin e nxënësve në zotërimin e rezultateve të nxënësve të përcaktuara për fushat kurrikulare (RNF);
- angazhimin e nxënësve në aktivitete extra-kurrikulare dhe
- angazhimin e nxënësve në menaxhimin e progresit vetanak.

Performanca e nxënësve bëhet e dukshme përmes efikasitetit të iniciativave që nxënësit i ndërmarrin në veprimtaritë e shkollës, rezultateve të nxënësve në vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, numrit të projekteve të realizuara nga nxënësit, përfaqësimit dhe suksesit të nxënësve në gara të ndryshme të dijes e shkathtësive në nivel të shkollës, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe përfshirjes me sukses të nxënësve në nivele të tjera të shkollimit.

Siç është paraqitur edhe në skemën vijuese, *performanca e nxënësve është fusha thelbësore e performancës së shkollës pasi që pasqyron efektivitetin e punës së përgjithshme të shkollës në realizimin e misionit thelbësor të saj.*



Pra, funksioni themelor i shkollës ka të bëjë me krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillim të kompetencave dhe realizim të potencialit të secilit nxënës si dhe për avancim të vazhdueshëm të nivelit të arritshmërisë së nxënësve. Prandaj, të gjitha fushat e veprimitarisë së shkollës duhet ti kontribuojnë përmbushjes së këtij funksioni, respektivisht zhvillimit të kompetencave të nxënësve.

Pjesa II: Përgatitja për zbatimin e kurrikulës

1. Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit shkollor për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës

Çfarë duhet të dini?

Korniza e Kurrikulës parasheh që udhëheqja e shkollës të punojë në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit për: (I) zhvillimin e një koncepti të qartë për shkollën, përfshirë vizionin dhe misionin e shkollës, dhe për (II) përmirësimin e cilësisë, barazisë dhe llogaridhënies mbi cilësinë e shërbimeve arsimore.

Zbatimi i kurrikulës së re shtetërore është një nismë shumë serioze dhe me ndikim të rëndësishëm në të gjitha aspektet e punës së shkollës.

Prandaj,

Udhëheqja e shkollës duhet të bashkëpunojë me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe partnerët tjerë për të zhvilluar dhe formësuar një vizion të përbashkët.

Përfshirja e gjithë komunitetit shkollor që në fazën fillestare të planifikimit për zbatimin e kurrikulës është parakusht i rëndësishëm për rritjen e përfshirjes në zbatim si dhe shton përgjegjësinë dhe llogaridhënien e të gjithë faktorëve të procesit mësimor.

Komunitetin shkollor (përveç kuadrit udhëheqës të shkollës) e përbëjnë: nxënësit, prindërit, kuadri mësimor, kuadri profesional, kuadri teknik dhe kuadri administrativ.

Si duhet të veproni?

Për të formësuar një vizion të përbashkët dhe për të siguruar përfshirjen e të gjithë komunitetit shkollor në procesin e zbatimit të kurrikulës, udhëheqja e shkollës duhet të sigurojë që fillimisht gjithë komuniteti shkollor:

- të jetë i njoftuar me mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës;
- t'i ketë të qarta implikimet e kurrikulës së re në praktikën shkollërore të shprehura në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës;
- të jetë i vetëdijshëm për pjesën e vet të përgjegjësisë në arritjen e atyre qëllimeve;
- të jetë i njoftuar me aktivitetet përgatitore të shkollës¹¹, afatet kohore të realizimit të tyre dhe format e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces.

Organizimi i takimeve informative dhe konsultuese duhet të inicohet nga udhëheqja e shkollës e cila në bashkëpunim me organet tjera qeverisëse të shkollës, duhet të:

- përcaktojë datat e takimeve,
- pjesëmarrësit në takime,
- çështjet që do të prezantohen,
- moderatorët e takimeve.

¹¹ Në lidhje me aktivitetet përgatitore, shih kapitujt vijues (2-7).

Në vijim janë dhënë disa orientime të përgjithshme për organizimin e këtyre takimeve.

a. Informimi i organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës

Për të ushtruar rolin e vet në funksion të zbatimit të kurrikulës organet qeverisëse të shkollës dhe organet profesionale të saj fillimisht duhet ta kuptojnë ndryshimin që sjell fryma e re e kurrikulës dhe ndikimin e saj në punën e përgjithshme të shkollës. Për këtë qëllim, fillimisht duhet të analizohen me shumë kujdes:

- Korniza e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar në Kosovë dhe KB,
- Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës,
- Treguesit e performancës së shkollës dhe
- Pjesa I e këtij doracaku.

Mbi këtë bazë këto organe duhet të rishikojnë rolin dhe funksionin e tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit të performancës së shkollës.

b. Informimi i kuadrit mësimor

Roli i mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës është qenësor prandaj ata duhet të jenë të qartë për pritshmëritë e reja dhe mundësitë që ofron kurríkula e re. Prandaj, organizimi i takimeve me kuadrin mësimor, lidhur me informimin dhe sensibilizimin e tyre për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re, ka rol të veçantë në këtë proces.

Çështjet kryesore për prezantim dhe diskutim me kuadrin mësimor përfshijnë:

- Parimet e Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar dhe ndikimi i tyre në funksionin e shkollës,
- Roli i ri i shkollës,
- Fushat e cilësisë së performancës së shkollës,
- Dallimet kryesore ndërmjet organizimit të mësimdhënies në një sistem që bazohet në përmbajtje prej një sistemi që bazohet në kompetenca,
- Planifikimi dhe realizimi i proceseve mësimore në funksion të mësimin të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore,
- Prioritetet e shkollës gjatë fazës përgatitore për zbatim.

Sa i përket burimeve të informacionit, për pikat 1-3 mund të shfrytëzohet:

- Pjesa e parë (I) e këtij doracaku
- Korniza e Kurrikulës, me theks të veçantë në kapitujt vijues:
 - Parimet e Kornizës së Kurrikulës dhe
 - Roli i ri i shkollës.

Për pikat 4-5 mund të shfrytëzohet Pjesa III dhe IV e këtij doracaku.

Takimi i parë informativ me kuadrin mësimor duhet të udhëhiqet nga drejtori i shkollës dhe pedagogu i shkollës¹². Në takimin e parë prezantohen çështjet e propozuara (më lart) dhe evidentohen të gjitha shqetësimet, dilemat apo paqartësitë eventuale të mësimdhënësve¹³.

Në takimin e dytë duhet të sqarohen të gjitha çështjet në mënyrë që kuadri mësimor të jetë i qartë sa i përket ndryshimeve kryesore në praktikat e planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, arsyeshmërisë për ndryshim, pritshmërive themelore nga shkolla (respektivisht nga akterët kryesorë në shkollë), formave të përkrahjes së mësimdhënësve dhe prioriteteve të shkollës gjatë fazës përgatitore për zbatim.

Në këto takime, në cilësinë e personave burimorë, mund të ftohen edhe përfaqësues të DKA-së apo të shkollave të cilat kanë qenë të përfshira në fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të kurrikulës.

c. Informimi i nxënësve dhe i prindërve

Takimet informative me nxënësit dhe prindërit e tyre duhen realizuar nga mësimdhënësit kujdestarë. Nxënësit dhe prindërit e tyre, që në fazat e para të përgatitjes së shkollës për zbatimin e kurrikulës së re, njoftohen me:

- Mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re;
- Kompetencat kryesore dhe rezultatet që duhen arritur nga nxënësit në fund të shkallëve përkatëse kurrikulare (për nxënësit e klasës së parë, pritshmëritë në fund të shkallës së parë; për nxënësit e klasës së tretë, pritshmëritë në fund të shkallës së dytë; e kështu me radhë);
- Apektet kryesore të organizimit të proceseve mësimore (format e punës me nxënës, burimet e të nxënësve, mënyrat e vlerësimit, etj.);
- Obligimet e shkollës, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve;
- Mundësitë dhe format e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes

Për këtë qëllim mund të përgatiten edhe fletushka informative me pikat kryesore për secilën nga çështjet e listuara më lart, të përditësohet dhe azhurnohet ueb faqja e shkollës me materiale informative për kurrikulën e re, me mundësi të shtrimit të pyetjeve nga komuniteti i shkollës dhe ofrimit të përgjigjeve për këtë proces, etj¹⁴.

¹² Apo Koordinator i Cilësisë, respektivisht personi përgjegjës për koordinimin dhe përkrahjen e procesit të zbatimit të kurrikulës në shkollë

¹³ Për të gjitha çështjet e hapura (për të cilat udhëheqësit e takimit nuk kanë arritur të ofrojnë sqarimet përkatëse), ata duhet të konsultohen me MASHT -in dhe/apo IPK-në.

¹⁴ Shkollat që nuk kanë ueb faqe obligohen që në afatin më të shkurtër të mundshëm të hapin ueb faqen e shkollës dhe ofrojnë materialet informative për akterët e shkollës.

Nxënësit dhe prindërit duhet, po ashtu, të jenë pjesë e proceseve përgatitore të shkollës për zbatim të kurrikulës, përfshirë në:

- Analizën e kontekstit të përgjithshëm të shkollës;
- Definimin e profilit të shkollës, vizionit dhe misionit të saj;
- Procesin e vetëvlerësimit të shkollës dhe përcaktimit të prioriteteve për përmirësim.

2. Analiza e kontekstit të përgjithshëm të shkollës

Për përcaktimin e vizionit dhe misionit të përbashkët, respektivisht për të ndërtuar profilin e saj, udhëheqja e shkollës fillimisht duhet të iniciojë procesin e analizës së kontekstit të përgjithshëm të shkollës. Ky është hapi i parë që duhet të ndërmerret nga shkolla, menjëherë pas informimit të komunitetit shkollor me kërkesat e reja të kurrikulës dhe implikimet e kurrikulës së re në praktikën shkollë.

Procesi i realizimit të kësaj analize duhet të jetë gjithëpërfshirës në mënyrë që gjithë komuniteti shkollor të ketë një qëndrim të përbashkët për sa i përket situatës dhe veçorive të shkollës.

Kjo analizë duhet të fokusohet në:

- situatën demografike të nxënësve dhe lokalitetit ku vepron shkolla,
- profilin ekonomik-social, kulturor e arsimor të familjeve të nxënësve,
- problemet kryesore me të cilat përballë komuniteti në të cilin vepron shkolla dhe ndikimin e tyre në performancën e nxënësve.

Për këtë qëllim, udhëheqja e shkollës duhet të caktojë një ekip punues, i cili është bartës i realizimit të kësaj analize.

3. Vetëvlerësimi i performancës së shkollës në raport me pritshmëritë e kurrikulës së re

Për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, respektivisht vetëvlerësimit të shkollës, nën dritën e kërkesave të kurrikulës së re, IPK ka përpiluar një udhëzues të veçantë ¹⁵. Ky Udhëzues mund të shfrytëzohet edhe për vetëvlerësimin fillestar të shkollës.

¹⁵ Shih: Udhëzues për vlerësim të brendshëm të shkollës, IPK, Prishtinë, 2016.

Por, procesi i vetëvlerësimit fillestar rekomandohet që t'i mbulojë të gjitha fushat e veprimtarisë së shkollës, në mënyrë që analiza e situatës të jetë e plotë dhe t'i shërbejë shkollës në përgatitjet e saj dhe në orientimin e punës për fillimin e zbatimit të kurrikulës së re.

Me këtë rast, udhëheqja e shkollës duhet të sigurojë respektimin e parimeve kryesore të procesit të vetëvlerësimit, që janë:

- Pjesëmarrja – gjithë komuniteti shkollor ka të drejtë dhe detyrë, sipas përgjegjësiwe personale dhe profesionale, të marrin pjesë në krijimin e një pasqyre sa më të saktë për gjendjen dhe trendet zhvillimore në shkollë; njëkohësisht, të gjithë do të jenë pjesë e planifikimit dhe zbatimit të masave përmirësuese në shkollë, në pajtim me gjetjet e vetëvlerësimit;
- Transparenca – të gjithë anëtarët e personelit, nxënësit dhe prindërit do të jenë të informuar hollësisht për procedurën e vlerësimit të brendshëm dhe do të jenë pjesë aktive e implementimit të tij. Njëkohësisht, varësisht nga roli, të gjithë faktorët do të informohen edhe për rezultatet e vlerësimit dhe masat për përmirësimin e performancës.
- Objektiviteti – procesi i vlerësimit është organizuar në atë mënyrë që të sigurojë një pasqyrë reale e të paanshme të gjendjes lidhur me performancën e shkollës në tërësi dhe të faktorëve individualë, në veçanti.
- Saktësia – të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura do të jenë të sakta, të matshme dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë për të gjitha palët e interesuara në procesin e vlerësimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të performancës së shkollës.

Kini kujdes!

Disa nga kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës, në bazë të të cilëve ju do të bëni vlerësimin e performancës së shkollës tuaj, i referohen pritshmërive të reja nga shkolla. Kjo do të thotë se deri në këtë moment shkolla juaj nuk është angazhuar fare në përmbushjen e tyre, dhe, kjo nuk duhet të ju shqetësojë. Qëllimi i vetëvlerësimit të parë është konstatimi i gjendjes së shkollës në raport me pritshmëritë e reja. Mbi këtë bazë ju i planifikoni masat e nevojshme për zhvillimin e shkollës tuaj dhe përmbushjen e pritshmërive të reja që janë elaboruar në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës.

4. Përcaktimi i vizionit dhe misionit të përbashkët të shkollës

Mbi bazën e analizës së kontekstit në të cilin vepron shkolla dhe mbi bazën e raportit të vetëvlerësimit, shkolla përcakton vizionin dhe misionin e saj.

Me rastin e përcaktimit të vizionit të shkollës kini parasysh se vizioni i shkollës përcakton orientimin strategjik të shkollës për ndërtimin e profilit të saj dhe jo cakun që duhet arritur...

Misioni i shkollës përcakton detyrimin që merr shkolla për arritjen e vizionit të saj dhe për të përmbushur funksionin e përcaktuar me kuadrin rregullativ të punës së shkollës¹⁶.

Misioni i shkollës duhet të përmbajë së paku tre komponentët vijues:

- Përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të tyre,
- Adresimin e problemeve kryesore me të cilat përballlet komuniteti në të cilin vepron shkolla,
- Avancimin e praktikës shkollëre përmes zgjidhjeve të aplikuara dhe dokumentuara në zbatimin e kurrikulës¹⁷.

Balansi ndërmjet këtyre tre komponenteve të veprimit e bën shkollën funksionale dhe e mban brenda rolit të saj thelbësor.

5. Përpilimi i planit zhvillimor të shkollës për zbatim të kurrikulës

Duke u bazuar në raportin e vetëvlerësimit, identifikohen prioritetet, respektivisht intervenimet e nevojshme për zbatimin e kurrikulës në kuadër të secilës fushë të cilësisë së performancës së shkollës¹⁸.


¹⁶ Ligji për arsimin parauniversitar dhe Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës

¹⁷ Zbatimi i plotë dhe i suksesshëm i kurrikulës është i mundur vetëm me kontributin e shkollave përmes dokumentimit të zgjidhjeve të aplikuara në adresimin e sfidave të ndryshme me të cilat mund të përballen gjatë zbatimit. Këto zgjidhje të aplikuara nga shkollat mund të shërbejnë jo vetëm për përmirësimin e procesit të zbatimit (duke vendosur një mekanizëm të validimit dhe shkëmbimit të tyre nga MASHT dhe DKA-të) por edhe për avancimin e politikave arsimore përmes një qasje nga poshtë-lart.

¹⁸ Format, përmbajtja, struktura, përgjegjësit dhe procedurat për hartimin e planit zhvillimor të instucioneve të arsimit parauniversitar përcaktohen me UA nr 23/2016 për Planin zhvillimor të shkollës dhe planin zhvillimor komunal të arsimit

Në fakt, vetëvlerësimi dhe planifikimi zhvillimor në shkollë janë pjesë të të njëjtit proces të sigurimit të cilësisë së shkollës.¹⁹

Siç është paraqitur më poshtë, ato janë pjesë e një cikli të vlerësimit dhe intervenimit të planifikuar e sistematik që për qëllim përfundimtar kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shkollore në funksion të rritjes së kompetencave të nxënësve.



Sa i përket planit zhvillimor të shkollës, udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që:

për çdo veprim të planifikuar në kuadër të planit të shkollës për përmirësim duhet të përcaktohen afatet kohore të realizimit, treguesit e realizimit, mjetet e verifikimit, kostoja tentative, burimi financiar, organi/personi përgjegjës dhe organet mbështetëse.

¹⁹ Në shtojcën 1 - janë dhënë format tabelare që duhet të përmbajë PZSH, i cili si tërësi duhet të jetë në funksion të zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit dhe avancimit të punës së shkollës.

6. Përpilimi i planit vjetor të veprimit për zbatimin e kurrikulës

Në kuadër të planit vjetor, shkolla duhet t'i identifikojë intervenimet me prioritet për të siguruar kushtet elementare për zbatimin e kurrikulës së re.

Disa nga këto intervenime mund të jenë:

- Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve për zbatimin e kurrikulës,
- Sigurimi i një mjedisi mundësues për zbatim të kurrikulës,
- Funksionalizimi i organeve qeverisëse të shkollës,
- Funksionalizimi i organeve profesionale të shkollës dhe
- Vendosja dhe konsolidimi i shërbimeve profesionale.

Në tabelën vijuese janë përshkruar aspektet kryesore që duhen pasur parasysh nga udhëheqja e shkollës, në kuadër të secilit prej këtyre intervenimeve.

Intervenimet imediate	Çka duhet të keni parasysh në kuadër të përgatitjeve për zbatim të kurrikulës?
<p>Zhvillimi i mësimitdhënësve për zbatimin e kurrikulës</p>	<p>Roli i mësimitdhënësit nuk konsiston në ofrimin e dijeve por në zhvillimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë.</p> <p>Prandaj, nga mësimitdhënësit pritet që t'i kenë të zhvilluara shkathtësitë sociale që u mundësojnë bashkëveprimin e nevojshëm me nxënës, prindër dhe kolegë; shkathtësitë e planifikimit, vlerësimit, monitorimit dhe zhvillimit të pavarur; aftësitë për organizim të proceseve efektive mësimore, duke pasur parasysh dallimet në sfondin social e ekonomik të nxënësve si dhe dallimet e interesave, afiniteteve dhe mundësive të tyre; shkathtësitë për shfrytëzimin e mundësive që ofron teknologjia e informimit dhe komunikimit.</p> <p><i>Programi i ZhPM në kuadër të përgatitjeve për zbatimin e kurrikulës së re duhet të ndërtohet duke pasur parasysh:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - rolin e ri të mësimitdhënësit të përcaktuar në Kornizën e Kurrikulës (të përmbledhur më lart), - rezultatet e vetëvlerësimit të shkollës. <p>Në këtë kontekst, përgatitja fillestare e mësimitdhënësve për zbatimin e kurrikulës do të duhej të fokusohet në:</p>

Intervenimet për sigurimin e një mjedisi mundësues për zbatim të kurrikulës

- metodat dhe praktikatat e planifikimit dhe realizimit të proceseve mësimore në funksion të zhvillimit të kompetencave,
- kërkesat e reja në raport me vlerësimin e nxënësve dhe raportimin mbi proceset mësimore.

Qasja inovative të cilën e promovon kurrikula e re kërkon entuziazëm, përkushtim, përgjegjshmëri dhe reflektim të vazhdueshëm kritik ndaj performancës vetanake në raport me mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës, prandaj udhëheqja e shkollës duhet t'i inkurajojë dhe t'i çmojë këto vlera.

Në Pjesën I, seksioni 3.2 janë trajtuar çështjet e përgjithshme për sigurimin e një mjedisi mundësues për zbatim të kurrikulës. Në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës janë definuar në detaje edhe treguesit e kriterëve për performancën e shkollës në kuadër të kësaj fushe.

Në vijim janë dhënë disa nga intervenimet të cilat duhet ndërmarrë në kuadër të përgatitjeve për zbatim të kurrikulës:

- Sigurimi i qasjes, lëvizjes së lirë dhe të sigurt për të gjithë nxënësit;
- Sigurimi i një mjedisi fizik të pastër, të sigurt, të këndshëm dhe stimulues për nxënie, aktivitete sociale dhe rekreative;
- Ndarja e përgjegjësive për sigurinë, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objektit shkollor, hapësirave përreth dhe burimeve mësimore;
- Planifikimi i hapësirave të shkollës në funksion të mësimin të integruar (në bazë të planifikimit të proceseve mësimore për shkallë kurrikulare dhe për vit shkollor)
- Planifikimi dhe sigurimi i burimeve bazike për realizimin e proceseve mësimore sipas kërkesave të kurrikulës së re (në bazë të planifikimit të proceseve mësimore për shkallë kurrikulare dhe për vit shkollor);
- Kultivimi i një klime miqësore dhe inkurajuese për gjithë komunitetin shkollor;
- Përpilimi i standardeve të mirësjelljes dhe kujdesit për gjithë komunitetin shkollor;
- Vendosja e një mekanizmi për identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e masave për përmbushjen e nevojave të ndryshme të nxënësve për nxënie;

Funksionalizimi i organeve qeverisëse të shkollës

- Vendosja e një sistemi të integruar dhe të koordinuar të shërbimeve mbështetëse për fuqizimin e nxënësve dhe familjeve të tyre përmes një bashkëpunimi efektiv me individë, familje, ofrues tjerë të shërbimeve dhe partner të tjerë të jashtëm të shkollës.

Procesi i themelimit të organeve qeverisëse duhet të ndihmohet nga drejtori i shkollës. Një aspekt shumë i rëndësishëm në procesin e themelimit të organeve qeverisëse janë procedurat e përzgjedhjes dhe përfaqësimit.

P.sh. nxënësit, para procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në Këshillin e Nxënësve, duhet të jenë të informuar për rolin e KN dhe për rolin e përfaqësuesve të tyre në këtë këshill. Edhe përfaqësuesit e nxënësve duhet të jenë të qartë se në Këshillin e Nxënësve ata përfaqësojnë shokët dhe shoqet e klasës së tyre dhe jo qëndrimin e tyre personal. Kjo nënkupton që së paku para çdo mbledhjeje të KN, anëtarët e këshillit duhet të organizojnë takime me nxënësit e klasave të tyre në mënyrë që t'i diskutojnë çështjet që janë planifikuar në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e këshillit. Në këtë mënyrë, secili përfaqësues (anëtar i KN) në mbledhjet e KN reflekton qëndrimet e klasës të cilën përfaqëson. Po ashtu, anëtarët e KN janë të obliguar që të njoftojnë nxënësit e klasës të cilën e përfaqësojnë me konkluzionet dhe vendimet e mbledhjeve të KN, më së largu një javë pas përfundimit të tyre. Procesverbalet nga takimet e anëtarëve të KN me nxënësit e klasave që përfaqësojnë duhet të përpilohen pas çdo takimi dhe bashkë me listat e pjesëmarrësve në takime të ruhen në një dosje të veçantë.

E njëjta vlen për procedurat e përzgjedhjes dhe përfaqësimit në kuadër të secilit organ qeverisës të shkollës, prandaj, këto çështje duhet të elaborohen qartë në rregulloret e punës së këtyre organeve.

Roli dhe funksioni i secilit organ qeverisës në procesin e zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit të performancës së shkollës duhet të definohet në konsultim me këto organe, shih Pjesa V, seksioni 2.

Funksionalizimi dhe fuqizimi i organeve

Roli dhe përgjegjësitë e kryesuesve të organeve profesionale për të siguruar bashkëpunimin e mësimitdhënësve për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e proceseve mësimore në nivel të

profesionale të shkollës

fushave dhe shkallëve kurrikulare duhet të jenë të përcaktuara qartë në rregulloren e punës së këtyre organeve.


Shih më tepër: Pjesa II, seksioni 3.

Shkëmbimi i përvojave, diskutimi i sfidave dhe zgjidhjeve të mundshme në përmirësimin e përvojave mësimore, mentorimi kolegial dhe format tjera të bashkëpunimit në funksion të zbatimit të kurrikulës së re janë po ashtu pjesë e rëndësishme e përgjegjësive të organeve profesionale të shkollave.

Vendosja dhe konsolidimi i shërbimeve profesionale

Për rolin dhe përgjegjësitë e shërbimeve profesionale në zbatimin e kurrikulës, t shih: Pjesa V, seksioni 4.

Në grafikun vijues është dhënë cikli i procesit të përgatitjeve dhe zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle.



7. Kalendari i mundshëm i aktiviteteve përgatitore të shkollës për zbatim të kurrikulës

#	Aktivitetet	Afatet kohore ²⁰					
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj-Qershor	Korrik-Gusht
1.	Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit shkollor						
2.	Realizimi i një analize të kontekstit të përgjithshëm të shkollës						
3.	Realizimi i një vetëvlerësimi të performancës së shkollës						
4.	Përcaktimi/rishikimi i vizionit dhe misionit të shkollës						
5.	Përpilimi/rishikimi i planit zhvillimor të shkollës ²¹						
6.	Përpilimi i planit vjetor të veprimit						
7.	Realizimi i aktiviteteve përgatitore për zbatim të kurrikulës ²²						
8.	Planifikimi i proceseve mësimore sipas kërkesave të kurrikulës ²³						

²⁰ Për shkollat të cilat janë në vitin e dytë apo të tretë të zbatimit ky kalendar dhe doracaku në tërësi mund të shfrytëzohet për të rishikuar planet dhe proceset e inicuar

²¹ Hartimi/rishikimi i PZHSH, duhet të bëhet në përputhje me përcaktimet e vendosura në UA nr.23/2016 për PZHSH.

²² Të planifikuara në planin vjetor të veprimit

²³ Më tepër për procesin e planifikimit shih: Pjesa III

Pjesa III: Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me bazë në shkollë

1. Mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës për planifikimin me bazë në shkollë

Qasja e bazuar në kompetenca zhvendos fokusin nga presioni për realizimin e përmbajtjes së përcaktuar me plan-programme dhe tekste shkollore, në zhvillimin e kompetencave të përcaktuara në kuadër të kurrikulës.

Kjo qasje u garanton shkollave një autonomi substanciale të vendimmarrjes për kurrikulën shkollore si dhe për organizimin e kohës shkollore në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore, por, brenda përcaktimeve të Kornizës së kurrikulës dhe kurrikulave bërthamë.

Dallimet kryesore ndërmjet organizimit të mësimdhënies në një sistem, që bazohet në përmbajtje prej një sistemi që bazohet në kompetenca mund të përmbliken si vijon:

Qasja e bazuar në përmbajtje	Qasja e bazuar në kompetenca
Përqendrimi në realizimin e përmbajtjeve të parapara dhe memorizimin e të dhënave faktike	Përqendrimi në atë se çka nxënësit do të dijnë dhe do të jenë në gjendje të bëjnë në fund të një periudhe të caktuar kohore, respektivisht një shkallë kurrikulare
Organizimi i punës në shkollë bazohet në kohë/orë mësimore (çfarë mund të realizohet për një orë mësimore)	Organizimi i punës në shkollë bazohet në rezultat (sa kohë nevojitet për të arritur rezultatin e caktuar)
Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies kryesisht bazohet në tekste shkollore	Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohet në hulumtime dhe burime të shumëllojshme
Përmbajtje e fragmentuar	Përmbajtje e integruar dhe ndërdisiplinare
Të nxënit në shkollë shpesh është i pakuptimtë për nxënësit	Të nxënit në shkollë ndërlidhet ngushtë me botën reale, është kuptimplotë dhe reflekton interesimet dhe përvojat e nxënësve
Procesi i mësimdhënies i referohet nxënësit mesatar	Procesi i mësimdhënies respekton dhe bazohet në diversitetin e nxënësve

Në tabelën vijuese janë dhënë gjashtë kompetencat kryesore të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës që duhen zhvilluar në shkollë dhe duhet të zotërohen nga të gjithë nxënësit që nga niveli parashkollor e deri në përfundimin e shkollës së mesme të lartë, respektivisht klasës së 12-të.

Gjashtë kompetencat kryesore të KKK	Rezultatet përfundimtare
1. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit	Komunikues efektiv
2. Kompetenca e të menduarit	Mendimtar kreativ
3. Kompetenca e të mësuarit	Nxënës i suksesshëm
4. Kompetenca që ka të bëjë me punën, jetën dhe mjedisin	Kontribuues produktiv
5. Kompetenca personale	Individ i shëndoshë
6. Kompetenca qytetare	Qytetar i përgjegjshëm

Këto kompetenca kanë karakter ndërkurrikular. Në Kurrikulat Bërthamë ato janë zbërthyer përmes rezultateve të të nxënimit për shkallë (RNSH) dhe rezultateve të të nxënimit për fusha kurrikulare (RNF), të cilat realizohen përmes lëndëve mësimore/fushave kurrikulare, formave të tjera të angazhimit të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj dhe kulturës së përgjithshme të shkollës.

Prandaj,

udhëheqja e shkollës duhet të sigurojë që kultura dhe organizimi i përgjithshëm i punës së shkollës si dhe çdo aktivitet që planifikohet dhe realizohet për nxënës dhe me nxënës të jetë në funksion të zhvillimit të këtyre kompetencave²⁴.

Kjo nënkupton nevojën që udhëheqja e shkollës t'i identifikojë me kohë të gjithë faktorët që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e kompetencave kryesore, të inkurajojë personelin e shkollës në gjetjen e zgjidhjeve për eliminimin e tyre dhe të përkrah zbatimin e këtyre zgjidhjeve²⁵.

Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e shkollës për:

²⁴ Shih (I) përshkrimin e kompetencave në Kornizën e Kurrikulës, (II) përshkrimin e kriterëve në kuadër të fushave të cilësisë Kultura dhe mjedisi shkollor dhe Mësimdhënia dhe të nxënimit (në pjesën I të këtij doracakut) dhe (III) treguesit e kriterëve të performancës së shkollës në Kornizën e vlerësimit të performancës së shkollës ²⁵Si më lart.

²⁵ Si më lart

- Përpilimin e planit mësimor brenda fleksibilitetit të lejuar për shfrytëzimin fleksibil të kohës mësimore mbi minimumin e kohës së përcaktuar me plan mësimor,
- Përpilimin e programit mësimor me elemente shtesë të programit sipas udhëzimeve në KB dhe programe lëndore, dhe
- Planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës me zgjedhje të kurrikulës.

Kini kujdes!

Fleksibiliteti në përpilimin e planit mësimor dhe autonomia në përpilimin e programit mësimor janë kryesisht në funksion të sigurimit të mundësive të barabarta për arritjen e rezultateve të të nxënit për fusha kurrikulare.

Autonomia në planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës me zgjedhje të kurrikulës është kryesisht në funksion të sigurimit të mundësive të barabarta për zotërimin e kompetencave kryesore.

2. Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me bazë në shkollë

a. Planifikimi i procesit mësimor për një shkallë kurrikulare

Shkallët kurrikulare, sipas të cilave strukturohet sistemi i kurrikulës, paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar nga të gjithë nxënësit, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit. Ato janë njësi kryesore për planifikimin, organizimin dhe vlerësimin e nxënësve dhe të shkollës.

Shkallët kurrikulare mbulojnë një deri tre vite shkollore, duke mundësuar respektimin e ritmeve individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe fleksibilitetin e nevojshëm për planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore në nivel të shkollës.

Korniza e Kurrikulës përcakton përqindjen e fondit të orëve për secilën fushë mësimore brenda një shkalle kurrikulare, përderisa fondi minimal i orëve për lëndë është dhënë në Kurrikulat Bërthamë dhe në planin mësimor për klasë, me autonomi që vet shkolla të

përcaktojë fondin e orëve mbi minimumin e përcaktuar për vit shkollor brenda përcaktimeve në Kurrikulat Bërthamë dhe programet lëndore.

Sipas Kurrikulave Bërthamë (Pjesa për autonominë e shkollës): Shkolla është e obliguar që t'u bëjë të mundur gjithë nxënësve të kalojnë minimumin e kohës mësimore të përcaktuar më plan mësimor. Për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe për ata që I tejkalojnë pritjet që janë paraparë me kurrikulë, përkatësisht me program mësimor shkolla mund të organizoj mësim plotësues dhe shtues mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor.

Mbi këtë minimum mund të përcaktoj kohë mësimore (orë mësimore) edhe për aktivitete jashtëkurrikulare. Për praktikatat e shfrytëzimit të kohës mësimore mbi minimumin e kohës së përcaktuar me plan mësimor, shkollat mund të vendosin në bashkëpunim me prindërit, nxënësit, autoritetet lokale të arsimit dhe palët e tjera të interesit, në mënyrë që shfrytëzimi i kësaj kohe mësimore, që është në autonomi të shkollës, të bëhet në mënyrë inovative dhe fleksibile dhe ti kontribuojë përkrahjes së nxënësve në zotërimin e kompetencave.

Kush e bën planifikimin për shkallë kurrikulare?

Planifikimi për shkallë kurrikulare zhvillohet nga Këshillat e klasave (KK)²⁶ përmes një procesi të ngushtë të bashkëpunimit me aktivet profesionale, ndërsa miratohet nga Këshilli i Mësimdhënësve.

Si bëhet planifikimi mësimor për shkallë kurrikulare?

Hapi 1: Identifikimi i mundësive për zhvillim të kompetencave kryesore dhe i mësimdhënësve që monitorojnë dhe raportojnë për efektivitetin e shkollës në zbatimin e tyre

➤ Me këtë rast Këshilli i klasës:

- Analizon të gjitha rezultatet e pritura në kuadër të kompetencave kryesore, të përcaktuara për shkallën përkatëse kurrikulare në KB,
- Identifikon praktikatat mësimore për zhvillimin e secilës kompetencë,
- Identifikon faktorët që mund të pengojnë zhvillimin e kompetencave,
- Propozon zgjidhjet për evitimin e faktorëve që mund të pengojnë zhvillimin e kompetencave,
- Propozon mësimdhënësit përgjegjës për secilën kompetencë²⁷.

²⁶ Për përbërjen, rolin dhe përgjegjësitë e Këshillave të shkollëve kurrikulare shih Pjesa II, seksioni 3.

²⁷ Mësimdhënësit përgjegjës për kompetencat përkatëse monitorojnë, mbledhin informata, përkrahin dhe raportojnë mbi zbatimin e masave të planifikuara për zhvillimin e kompetencave për të cilat janë përgjegjës. Mësimdhënësit përgjegjës për kompetencat mund të jenë mësimdhënësit që japin mësim në shkollën përkatëse kurrikulare, mund të jenë udhëheqësit e aktivave profesionale. Këta mësimdhënës përcjellin

Një vijim është dhënë një formë që mund të shfrytëzohet për planifikimin për shkallë kurrikulare –me fokus zhvillimin e kompetencave kryesore

shembull: Shkalla 3				
Kompetencat kryesore	Praktikat mësimore për zhvillimin e kompetencave ²⁸	Faktorët që mund të pengojnë zhvillimin e kompetencave	Zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e pengesave	Mësimdhënësi përgjegjës
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit				
Kompetenca e të menduarit				
Kompetenca e të mësuarit				
Kompetenca që ka të bëjë me punën, jetën dhe mjedisin				
Kompetenca personale				
Kompetenca qytetare				

Hapi 2: Përpilimi i planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare

Kurrikulat Bërthamë dhe programet mësimore të hartuara nga MASHT-i për klasët që mbulojnë një shkallë kurrikulare, janë bazë për përpilimin nga shkolla të planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare, i cili duhet të integrojë specifikat e shkollës dhe të sigurojë arritjen e rezultateve të nxëniet për gjatë shkallës kurrikulare, përmes:

- Një tërësi të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura;
- Lidhjes/koherencës ndërmjet temave dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një lënde mësimore, me synim zhvillimin e kompetencave;
- Përshtatshmërisë së temave për grupin e nxënësve me të cilët do të punojnë dhe për komunitetin në të cilin vepron shkolla;
- Fokusimit të planifikimeve mësimore në rezultate të nxëniet; dhe
- Zbatimit të praktikave të reja të mësimdhënies në nivel të lëndëve të fushës dhe në nivel klase/shkollë.

zhvillimin e kompetencave për për një shkallë kurrikulare ose për dy shkallët e kurrikulës brenda nivelit përkatës të arsimit, ndërsa për nxënësit e gjeneratës tjetër mund të caktohen mësimdhënës tjerë.

²⁸ Në këtë pjesë, për secilën kompetencë, listohen aktivitetet mësimore përmes të cilave shkolla planifikon ti kontribuoj zotërimit të RNS-ve, përfshirë: programin mësimor të lëndëve (të listohet secila lëndë që në shkollën përkatëse duhet ti kontribuoj drejtëpërdrejt zotërimit të RNSH-ve përkatëse), aktivitetet jashtëkurrikulare (të listohen aktivitetet konkrete që duhet të realizohen), etj.

Kini kujdes:

Për të lehtësuar punën e shkollave në zbatimin e kurrikulës së re, MASHT, në bazë të rezultateve të nxënit për fusha kurrikulare ka hartuar matricën e përmbajtjes për secilën klasë në lëndët përkatëse, nga klasa parafillore deri në klasën e 12.

MASHT ka vënë në dispozicion për shkollat edhe programet lëndore për klasë, të cilat krahas temave mësimore për lëndë, përmbajnë edhe rezultatet e të nxënit për temë/a, udhëzime metodologjike, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, udhëzime për vlerësim dhe udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

Në këtë rast, AP-të fillimisht analizojnë përshtatshmërinë e temave për grupin e nxënësve me të cilët do të punojnë dhe për komunitetin në të cilin vepron shkolla; mbi këtë bazë përcaktohen për temat që do të shtjellohen në kuadër të një fushe kurrikulare gjatë një shkalle kurrikulare.

Kjo tregon që gjatë përpilimit të planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare, në tavolinën e punës së aktivitetit profesional/ këshillit të klasave, duhet të jenë kurrikula bërthamë dhe programet lëndore që mbulojnë lëndët e fushave përkatëse brenda viteve të një shkalle kurrikulare. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, fillohet me analizën për përgatitjen e planit për shkallë kurrikulare, i cili duhet të orientojnë planifikimin vjetor për klasë, përkatësisht procesin e mësimdhënies dhe të nxënit në zhvillimin e kompetencave kryesore dhe arritjen e rezultateve të fushës kurrikulare në shkallët përkatëse të saj.

Analiza fillestare për përpilimin e planit dhe programit për shkallë kurrikulare, mund të sigurojë tri elementet kryesore që shkolla duhet ti adresojë në kuadër të planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare, me qëllim përkrahjen e nxënësve në zotrimin e kompetencave dhe arritjen e rezultateve të fushës:

- Konstatimin e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore në dispozicion dhe përcaktimin e orëve shtesë mbi minimumin e orëve për fushën/lëndën përkatëse brenda viteve që mbulon shkallën përkatëse kurrikulare;
 - Shtjellimin e temave të vendosura në programet lëndore dhe propozimin e temave të reja mësimore për arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare gjatë shkallës përkatëse kurrikulare;
 - Sigurimin e koherencës ndërkurrikulare.
- **Konstatimi i fondit të përgjithshëm të orëve mësimore në dispozicion dhe përcaktimi i orëve shtesë mbi minimumin e orëve për fushën/lëndën përkatëse brenda viteve që mbulon shkallë.**

Mësimdhënësit e lëndëve të fushave përkatëse, para se të bëhet planifikimi për shkallë:

- bëjnë një analizë të kohës mësimore (planit mësimor) dhe programit të lëndëve mësimore brenda shkallës përkatëse kurrikulare, me rezultatet e të nxënësve për fusha kurrikulare;
- përcaktojnë orët shtesë (mbi minimumin e orëve mësimore) për lëndët përkatëse;
- ofrojnë arsyeshmëri për kontributin e orëve shtesë në rezultatet e të nxënësve të fushës dhe të kompetencave kryesore për shkallë dhe orientim për realizimin e orëve shtesë gjatë viteve që mbulon shkalla kurrikulare.

Përmbledhja e punës në këtë fazë mund të bëhet në tabelën në vijim:

Fushat kurrikulare	Lëndët	Orët mësimore brenda viteve të shkallës përkatëse ²⁹		Mësimdhënësit përgjegjës		Arsyeshmëria për orë shtesë mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor	Disa orientime se si do të realizohen orët shtesë
		Kl. VI	Kl. VII	Kl. VI	Kl. VII		
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe						
	Gjuhë angleze						
	Gjuhë e dytë e huaj						
Artet	Edukatë figurative						
	Edukatë muzikore						
Matematika	Matematikë						
Shkencat natyrore	Lëndët e fushës						
Shoqëria dhe mjedisi	Lëndët e fushës						
Edukata fizike, sporti dhe shëndeti	Edukata fizike, dhe sporti dhe shëndeti						
Jeta dhe puna	Jeta dhe puna / Teknologji me TIK						
Gjithsej orë							

- **Shtjellimi i programeve lëndore dhe propozimi i temave të reja mësimore që do të ndihmojnë në arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare gjatë shkallës përkatëse kurrikulare**

²⁹ Përfshihen orët mësimore të përcaktuara me plan mësimor + numri i orëve shtesë mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor. Numri i orëve shtesë mbi minimumin, duhet të vendoset me kujdes, në mënyrë që nxënësit të mbështeten për atë që kanë nevojë dhe të mos krijohet mbingarkesë për moshën dhe aftësitë psiko-fizike të fëmijëve/nxënësve.

Siç u përshkrua më lartë, MASHT-i për të lehtësuar punën e shkollave në zbatimin e kurrikulës së re, në bazë të rezultateve të nxënimit për fusha kurrikulare ka hartuar matricën e përmbajtjes për secilën klasë në lëndët përkatëse, nga klasa parafillore deri në klasën e 12, si dhe ka filluar me hartimin e programeve lëndore për klasë, të cilat burojnë nga rezultatet e të nxënimit për fusha kurrikulare dhe konceptet e fushës (shih programet lëndore se si lidhen temat e programit lëndor për klasë me rezultatet e të nxënimit për fusha dhe me konceptet e fushës).

Kjo qasje nuk mund të sigurojë plotësisht zotërim të njejtë të rezultateve të nxënimit të fushës nga të gjithë nxënësit në Kosovë. Prandaj, bazuar në nevojën për përshtatshmërinë e temave për grupin e nxënësve me të cilët do të punojnë, mësimdhënësit e shkallës përkatëse të kurrikulës mund të propozojnë tema të reja mësimore që do të ndihmojnë në arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare gjatë shkallës përkatëse kurrikulare.

Propozimi i temave të reja mund të bëhet në bazë të:

- analizës së bërë për përshtatshmërinë e temave për grupin e nxënësve³⁰ me të cilët do të punojnë dhe për komunitetin në të cilin vepron shkolla;
- shtjellimit të temave nga programet lëndore të hartuara nga MASHT-i; dhe
- përcaktimit të orëve shtesë shtesë mbi minimumin e planit mësimor për lëndë mësimore brenda një viti shkollor, përkatësisht brenda një shkalle të kurrikulës.

Propozimin e temave e bëjnë aktivet profesionale, të ndarë sipas fushave kurrikulare.

Tabela në vijim është vazhdim i tabelës paraprake, që plotëson hapin tjetër të përplimit të planit dhe programit për shkallë kurrikulare.

³⁰ Merren për bazë veçoritë e nxënësve për të cilët është duke u planifikuar procesi mësimor me theks të veçantë në suksesin/arritshmërinë në klasën/shkallën paraprake (në zotërimin e kompetencave kryesore dhe në arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare).

Shkalla e kurrikulës:				
Fusha kurrikulare:				
Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare (RNF)	Propozimi i temave të reja mësimore që do të jenë pjesë e programit mësimor për shkallë	Orët mësimore	Arsyeshmëri a për numrin e orëve mësimore	Lëndët bartëse dhe Mësimdhënësit përgjegjës
Vendosen vetën rezultatet e fushës kurrikulare për shkallën përkatëse të kurrikulës, që synohet të arrihen përmes temave të reja mësimore (sepse temat në programet lëndore të hartuara nga MASHT janë të ndërlidhura me rezultatet e fushave kurrikulare).	<i>Temat propozohen - përcaktohen në përputhje me RNF dhe konceptet kryesore të fushës. Ideja për përcaktimin e temave mund të fillojë nga diskutimet brenda aktivitetit profesional, përvojat e mësimdhënësve për temat e realizuara në vitet paraprake, ose nga lista e temave të propozuara nga MASHT.</i>	<i>Orët mësimore vendosen për secilën temë mësimore. Vendosja e orëve mësimore duhet të bëhet mbi bazën e argumenteve për shtrirjen e temës – thellësinë dhe gjerësinë e trajtimit të temës në përputhje me veçoritë e shkallës dhe fushës kurrikulare së cilës i takon tema mësimore.</i>	<i>Bëhet një arsyetim i shkurtër i argumentuar për propozimin e orëve mësimore për secilën temë, duke patur parasysh shtrirjen dhe thellësinë e temës/ave që sigurojnë arritjen e RNF.</i>	<i>Për secilën temë, përcaktohet lënda bartëse dhe mësimdhënësit përgjegjës për realizimin e secilës temë</i>

Pakoja e propozuar e planeve të fushave për shkallë kurrikulare i dorëzohet Këshillit të mësimdhënësve për miratim. Pas miratimit nga KM, kjo pako e planeve për shkallë kurrikulare së bashku me programet lëndore të fushave përkatëse të kurrikulës, për klasët përkatëse, shërben si referencë për: **përpilimin e planit vjetor mësimor.**

■ Sigurimi i koherencës ndërkurrikulare

- Aktivitetet profesionale (AP) fillimisht prezantojnë në Këshillin e klasave temat e përcaktuara me programet lëndore dhe temat e përzgjedhura për shkallë, orët mësimore për temat e përzgjedhura dhe argumentet për arsyeshmërinë e numrit të orëve mësimore të propozuara për secilën temë;
- KK në koordinim me AP identifikon temat e përafërta në kuadër të dy apo më tepër fushave kurrikulare dhe vendos nëse:
 - temat përkatëse mund të realizohen vetëm në kuadër të një fushe kurrikulare (me ç’rast kursehen orët e planifikuara për realizimin e së njëjtës temë në kuadër të fushës tjetër, në favor të ndonjë teme tjetër),

- temat përkatëse mund të shkrihen duke rezervuar një kohë më të gjatë për realizimin e tyre (me ç'rast sigurohet një komoditet i konsiderueshëm për realizim më të plotë të atyre temave nga perspektiva e dy apo më tepër FK);
- KK në koordinim me AP finalizon listën e temave që do të zhvillohen në kuadër të të gjitha fushave kurrikulare gjatë shkollës përkatëse;

Kini kujdes:

Në kontekstin e praktikës shkollore, organizimi i nxënies së integruar kërkon punë të përbashkët të mësimitdhënësve, menaxhim fleksibil të kohës dhe të hapësirës.

Kurrikula e re kërkon integrimin e kompetencave profesionale të mësimitdhënëve, prandaj Këshilli i klasës duhet t'i shqyrtojë me kujdes përparësitë dhe mangësitë e secilit mësimitdhënës, që të mund të planifikojë dhe shfrytëzojë në mënyrë optimale kuadrin e saj mësimor.

b. Planifikimi mësimor vjetor

Planifikimi i përbashkët në kuadër të Aktivitetit profesional është kusht themelor në procesin e planifikimit vjetor.

Planifikimi i përbashkët në kuadër të fushës kurrikulare siguron një segment të rëndësishëm të qasjes së integruar dhe të zhvillimit kompetencave kryesore/rezultateve të nxënies të shkollës (RNK). Në kontekstin e praktikës shkollore, planifikimi i përbashkët dhe organizimi i nxënies së integruar kërkon punë të përbashkët të mësimitdhënësve, menaxhim fleksibil të kohës në dispozicion dhe të hapësirës shkollore e mjeteve mësimore. Zbatimi i kurrikulës, kërkon integrimin e kompetencave profesionale të mësimitdhënësve, prandaj aktiviteti profesional duhet t'i shqyrtojë me kujdes përparësitë dhe mangësitë në punën e tyre dhe mbi këtë bazë të planifikojnë dhe zbatojnë një plan vjetor në frymën e kurrikulës së re - qasjen e bazuar në kompetenca.

Duke u bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes, Korniza e Kurrikulës mundëson zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar kështu në zhvillimin e plotë të potencialeve të secilit nxënës. Duke i pasur parasysh nevojat individuale dhe stilet e të nxënies, përvojat mësimore në shkollë duhet të nxisin motivimin për mësim, si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollës dhe nivelit të arritjes së nxënësve.

Në këtë kontekst, kurrikula e re i mundëson shkollës që përmes autonomisë në përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe metodave të punës mësimore të sigurojë:

- të nxënë që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve, interesimet dhe mundësitë e tyre,
- të nxënë kuptimplotë (p.sh. i orientuar në zgjidhje të problemeve praktike nga përditshmëria jetësore) dhe
- përfshirje aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënësve, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojave të caktuara dhe në gjendje për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënësve.

Prandaj, shtjellimi dhe zberthimi i temave mësimore të vendosura në programet mësimore për klasë, si dhe zhvillimi i temave të reja, duhet të sigurojë mundësi për:

- Realizimin e proceseve sfiduese dhe atraktive mësimore;
- Zotërimin e rezultateve të të nxënësve për kompetenca (RNSh-ve);
- Zotërimin e rezultateve të të nxënësve për fushat përkatëse kurrikulare (RNF-ve);
- Mësim gjithëpërfshirës dhe të plotë, që integron dhe reflekton lidhjet dhendërvarësitë në botë;
- Ndërlidhje ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si: zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale;
- Integrim të fushave të reja kurrikulare që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës (si teknologjia e komunikimit dhe informimit, mësimi elektronik, vetëdijësimi mbi mediet, shkathtësitë jetësore);
- Perspektivën e mësimin tërë-jetësor me theks të posaçëm në kompetencat për të nxënësve, për përdorimin e teknologjive të reja dhe kompetencat për vlerësimin dhe përpunimin e informacioneve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme.

Kini kujdes!

Të gjithë anëtarët e AP/ KK duhet t'i shqyrtojnë programet mësimore para takimit të KK. Në takimin e KK i cili në rend dite ka shqyrtimin e programeve mësimore diskutohen komentet dhe bëhen intervenimet e nevojshme për finalizimin dhe miratimin e programeve.

Nga mësimdhënësit pritet që të shfrytëzojnë fleksibilitetin e shtuar në planifikimin e proceseve mësimore në shkollë për shfrytëzimin e një game të gjerë të metodave mësimore dhe formave të punës, të përshtatshme për qasje interaktive dhe të individualizuar të punës me nxënës, drejt arritjes së rezultateve të përcaktuara të të nxënësve dhe zhvillimit të kompetencave kryesore.

Të gjitha këto aspekte kërkojnë kohë të konsiderueshme dhe qasje inovative të planifikimit dhe realizimit të proceseve mësimore, prandaj:

Udhëheqja shkollës duhet të sigurojë që planet dhe programet mësimore, kuadri mësimor, mjedisi fizik i shkollës, organizimi dhe klima e përgjithshme e shkollës të mundësojnë realizimin e proceseve mësimore sipas kërkesave të lartpërmendura.

Cilët janë hapat që duhen ndjekur gjatë përgatitjes së planit vjetor?

Hapi i parë – Përgatitja për planifikim

- Sigurimi i dokumenteve të kurrikulës (kurrikulën bërthamë, planin mësimor, programet mësimore për lëndë, planin dhe programin e përgatitur për shkollë kurrikulare, kalendarin shkollor dhe raportet e punës nga klasa paraprake, si libri i klasës dhe raporte të tjera),
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të gjithë mësimeve të fushës, lëndës dhe klasës përkatëse.

Përgatitja e mirë për planifikim mbështetet edhe në përvojat, mundësitë dhe interesat e nxënësve.

Hapi i dytë: Analiza përmbajtësore

Aktivi profesional analizon dhe shqyrton:

- përvojat e mësimeve për temat e programeve lëndore (nëse të njëjtat janë realizuara në vitet paraprake),
- temat e reja që për herë të parë fillojnë të zhvillohen në klasën dhe lëndën përkatëse,
- lidhja e temave mësimore me lëndët tjera brenda fushës së kurrikulës dhe me lëndët tjera,
- rendi logjik i trajtimit të temave gjatë vitit mësimor,
- thellësia dhe gjerësia e trajtimit të temës në përputhje me veçoritë e klasës, zhvillimin dhe interesat e nxënësve
- kohën mësimore minimale të përcaktuar me planin mësimor (orët e mësimimit që i ka secila lëndë mësimore brenda një viti shkollor për klasën përkatëse)
- mundësitë që ofron shkolla për organizimin e orëve të mësimimit mbi kohën minimale totalin javor të orëve, organizimin e mësimimit plotësues dhe shtues, etj.
- ndarjen e vitit mësimor në tri periudha dhe mundësitë e realizimit të programit të lëndëve brenda secilës periudhë të vitit mësimor, etj.

Hapi i tretë: Vendosja e temave në periudhën dymujore

Brenda një periudhe dymujore mund të trajtohen disa tema mësimore, (preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të vazhdojnë të trajtohen edhe në periudhën vijuese dymujore, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të behet mbi analizën dhe konkluzionet e bëra në hapin e dytë.

Hapi i katërt: Vendosja e numrit të orëve mësimore për tema mësimore

Për të përcaktuar kohëzgjatjen e temave mësimore, mësimdhënësi duhet të konsultojë planin mësimor për klasë dhe lëndë mësimore, të miratuar nga MASHT-i. Vendosja e numrit të orëve mësimore bëhet në bazë të konkluzioneve të bëra nga hapi i dytë, përkatësisht nga rezultatet e të nxënit për temë. Afër secilës temë për lëndën përkatëse vendoset numri i orëve mësimore për temë (p.sh. 4 orë). Vendosja e orëve mësimore për tema mësimore në kuadër të planifikimit vjetor mund të jetë orientuese dhe fleksibile me mundësi ndryshimi gjatë zërthimit të planeve dymujore. Vendosja e orëve mësimore për tema në këtë fazë siguron një pasqyrë të mbulueshmërisë së programit mësimor brenda kohës mësimore që secila lëndë mësimore ka në dispozicion dhe brenda kalendarit shkollor.

Hapi i pestë: Vendosja e rezultateve të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës

Në kolonën për kontributin e temave të përcaktuara në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca të cilave i kontribuon tema e propozuar për periudhën përkatëse. Për çështje praktike rezultatet mund të shënohen me numra origjinal (sic janë të numeruar në KB). Të gjitha lëndët mësimore, për sa klasë që ka shkalla kurrikulare, duhet t'i mbulkojnë të gjitha rezultatet e kompetencave, d.m.th. nëse shkalla i ka dy klasë atëherë për dy vite shkollore-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën Bërthamë.

Çka duhet të përmbaj planifikimi vjetor?

Programet mësimore janë bazë e organizimit të procesit mësimor-edukativ në kuadër të lëndës mësimore, për çdo nivel arsimor dhe shkallë kurrikulare. Secili program lëndor, nga pikëpamja e organizimit të materialit, paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:

- Hyrje;
- Qëllimi;
- Temat dhe rezultatet e të nxënit;
- Udhëzime metodologjike;
- Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare;
- Udhëzime për vlerësim;
- Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

Në instrumentin e planifikimit vjetor, përfshihen vetëm temat mësimore, të shpërndara gjatë muajve dhe të organizuara në tri periudha të vitit mësimor, si dhe kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës. Aspektet tjera të programit lëndor, përfshihen në planifikimin dymujor, javor dhe ditor. Tabela në vijim pasyron aspektet që duhet të përmbajë plani vjetor i lëndëve brenda një fushe kurrikulare.

Lëndet e fushës	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator-Tetor	Nëntor Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars – Prill (java I)	Prill - Maj	Qershor	
Lënda							
Lënda							
Lënda							

c. Planifikimi mësimor dymujor

Planifikimi i njësive mësimore bëhet në bazë të programit mësimor për klasë, sipas kohëzgjatjes së temave mësimore brenda vitit shkollor. Hartohet nga aktivet profesionale në nivelet II dhe III (ShK 3- 6), ndërsa për nivelin fillor (ShK 1 dhe 2) bëhet nga mësimdhënësit klasorë në konsultim me mësimdhënësit përkatës lëndorë.

Me këtë rast, për çdo temë të planifikuar - në raport me kohëzgjatjen e saj- përcaktohen dhe elaborohen njësitë mësimore (shih tabela në vijim³¹). Kohëzgjatja e periudhës kohore për një temë mësimore mund të jetë një muaj, dy muaj ose edhe një gjysmëvjetor – varësisht nga shtrirja dhe thellësia e temës në funksion të RNF³².

Një temë mësimore mund të realizohet përmes disa njësive mësimore. Planifikimi i njësive mësimore bëhet për një periudhë (dymujore). Me rastin e planifikimit, aktivet profesionale, përveç programit mësimor për shkallë kurrikulare, në mënyrë të veçantë

³¹ Forma e plotë është dhënë në Shtojcën 5.

³² Shih tek pika (a), Hapi 2 Përpilimi i planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare- përcaktimi i lëndëve bartëse dhe mësimdhënësve përgjegjës.

duhet të marrin në konsideratë rezultatet e vlerësimit të nxënësve në fund të periudhës paraprake³³.

Tabela në vijim pasyron aspektet që duhet të përmbajë plani dymujor i një lënde mësimore.

Tema/t mësimore (marrë nga plani vjetor)	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Rezultatet e të nxënit për njësi mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe situatat jetësore	Burimet dhe përgatitjet e nevojshme

Forma e mësipërme mund të shërbejë që temat të vendosen me rradhë, për të gjithë muajt që mbulon një periudhë e vitit mësimor.

d) Përpilimi i orarit mësimor dhe planit javor

Orari mësimor përpilohet nga Këshillat e klasave.

KK fillimisht përgatit orarin mësimor. Orari mësimor mund të vlejë për një gjysmëvjetor dhe përgatitet për cdo paralele të klasës përkatëse³⁴. Orari mësimor përfshin numrin e orëve për lëndë sipas planit zyrtar të mirtuar nga MASHT-i dhe numrin e orëve shtesë të vendosura nga shkolla, mbi minimumin e orëve mësimore për një javë mësimore.

Përpilimi i orarit mësimor duhet të ketë prioritet nxënësit – me fokus integrimin kurrikular.

Pas miratimit të orarit mësimor, fillohet me planin javor i cili përpilohet nga të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në klasën/klasat përkatëse, nën udhëheqjen e Kryetarit të Këshillit të klasave, apo personit të autorizuar nga shkolla.

³³ Shih më tepër në lidhje me administrimin e rezultateve të vlerësimit të nxënësve, në Pjesën IV, Seksioni 3

³⁴ Në gjysmëvjetorin e dytë mund të përgatitet orari i ri mësimor ose mund të jetë i njëjti.

Përpilimi i planit javor, bazohet në planin mësimor dymujor. Këshillat e klasave duhet të përkujdesen që të sigurojnë një integrim sa më të lartë kurrikular. Për të arritur këtë, KK-të përveç planifikimit të përbashkët për shkallë kurrikulare, vit shkollor, kujdesen që të mirëmbajnë një model të planifikimit javor, ku afër secilës lëndë vendosin njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë për çdo ditë dhe integrimin ndër-lëndor.

Shih në shtojcën 6 modelin e planit javor për klasë.

Kini kujdes
Pjesa me zgjedhje është vënë në dispozicion për shkollat si mundësi për të adresuar diskrepancën eventuale ndërmjet profilit të nxënësve të shkollës së caktuar dhe pritshmërive të përcaktuara me KB për zotërimin e kompetencave kryesore

e) Plani i orës mësimore

Planifikimi i orës mësimore bëhet nga mësimdhënësi i lëndës përkatëse, bazuar në planin mësimor për periudhë, specifikat e klasës/paraleleve me të cilën/at punon.

Gjatë planifikimit të orës mësimore, mësimdhënësi duhet të sigurojë që rrjedha e orës mësimore është në funksion të hirearkisë së rezultateve të të nxënësve – për tema mësimore – fushë kurrikulare – kompetenca.

Për çdo orë/njësi mësimore duhet të përcaktohet:

- Qëllimi i orës mësimore dhe rezultatet e të nxënësve për orë mësimore³⁵ (përkujdeset qëllimi i orës mësimore dhe pritshmëritë për arritshmërinë e nxënësve në fund të orës mësimore),
- Konceptet kryesore të orës mësimore, (konceptet e rëndësishme që duhet të zotërohen nga nxënësit gjatë orës mësimore
- Përgatitjet e nevojshme (sigurimi i pajisjeve, burimeve, fotokopjimi i materialeve, etj.),
- Plani i orës mësimore (përkujdeset rrjedha e orës mësimore dhe koha e nevojshme për çdo aktivitet, qasja që do të përdoret për vlerësiminformativ në raport me rezultatet e të nxënësve për orë mësimore).

³⁵ Rezultatet e pritura duhet të jenë drejtpërdrejt në funksion të arritjes së rezultateve të fushës kurrikulare dhe zhvillimit të kompetencave sipas pritshmërive të përcaktuara për shkallën përkatëse kurrikulare me KB.

E rëndësishme është që formati i përshkrimit të orës mësimore të përmbajë të gjitha elementet e përcaktuara më lart; organizimi i përshkrimit është në autonomi të shkollës dhe mësimdhënësve të saj.

Një formë e planit të orës mësimore është dhënë në Shtojcën 8.

3. Udhëheqja e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje

Pjesa zgjedhore e kurrikulës është një mundësi për shkollën që:

- të shtojë fondin e orëve në kuadër të lëndëve të caktuara nëse fondi i tyre në dispozicion nuk lejon realizimin e një apo disa temave të rëndësishme, ndërsa arsyeshmëria për realizimin e tij/tyre është e lartë dhe e pranuar nga KShK dhe
- zhvillimin dhe zbatimin e elementeve plotësuese kurrikulare, respektivisht temave ndërkurrikulare, për të trajtuar ndonjë temë të veçantë dhe relevante për komunitetin në të cilin vepron shkolla por në funksion të drejtpërdrejtë të zhvillimit të kompetencave kryesore.

Për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje në nivelin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lart- gjimnazi i përgjithshëm, fillimisht analizohen rezultatet e pritura për zotërimin e kompetencave kryesore dhe veçoritë e nxënësve të gjeneratës e cila fillon shkollën përkatëse kurrikulare. Kurrikula me zgjedhje duhet t'i adresojë pikat më të dobëta që identifikohen në mesin e gjeneratës për të cilën planifikohet kurrikula zgjedhore.

Një referencë e rëndësishme për planifikimin e pjesës zgjedhore është lista e faktorëve të identifikuar nga KShK që mund të pengojnë zhvillimin e kompetencave (shih Hapi 1 i planifikimit për shkollë kurrikulare); pra pjesa e kurrikulës me zgjedhje mund të shërbejë për adresimin e ndonjë prej faktorëve.

Për shkollat e nivelit të mesëm të lartë (gjimnazet specifike dhe shkollat profesionale), fondi i orëve në dispozicion për kurrikulën me zgjedhje duhet të shfrytëzohet në përputhje me profilin e shkollës³⁶, p.sh. në Gjimnazin gjuhësor, pjesa me zgjedhje mund të shfrytëzohet për fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi - respektivisht për lëndët përkatëse.

Planifikimi dhe realizimi i pjesës me zgjedhje të kurrikulës zhvillohet dhe vlerësohet si çdo element tjetër kurrikular. Kjo nënkupton se:

- Nëse kurrikula me zgjedhje është në formë të një teme, në kuadër të një lënde të caktuar, ai realizohet dhe vlerësohet si çdo fushë tjetër tematike në kuadër të asaj lënde;

³⁶ Edhe në këto situata, shkolla duhet t'i respektojë edhe orientimet e përgjithshme (të përshkruara më lart) me rastin e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje.

- Nëse kurrikula me zgjedhje është në formë të një lënde, ajo planifikohet dhe realizohet si çdo lëndë tjetër, në kuadër të fushës përkatëse kurrikulare.

Udhëheqja shkollës duhet të sigurojë që planifikimi i pjesës me zgjedhje të kurrikulës bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga MASHT në KKAP, në KB dhe në Udhëzimin Administrativ për planifikimin dhe organizimin e kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar³⁷.

4. Format e planifikimit dhe organet përgjegjëse - përmbledhje tabelare

Format e planifikimit	Organet profesionale	
	Përpilimi, monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin ³⁸	Miratimi dhe mbikëqyrja e zbatimit ³⁹
Plani për zhvillimin e kompetencave kryesore gjatë ShK	Këshillat e klasës dhe AP	Këshilli i mësimdhënësve
Plani mësimor për klasë/lëndë gjatë një ShK		
Planifikimi vjetor	Aktivitet profesionale	Aktivitet profesionale, Këshillat e klasës
Planifikimi periudha të vitit mësimor /dymujor	Aktivitet profesionale	Aktivitet profesionale, Këshillat e klasës
Plani javor	Aktivitet profesionale	Aktivitet profesionale, Këshillat e klasës
Planifikimi i orës mësimore	Mësimdhënësi	Mësimdhënësi
Planifikimi i pjesës zgjedhore të kurrikulës	Këshillat e Klasës	Këshilli i mësimdhënësve

³⁷ Më gjerësisht, shih Udhëzimin Administrativ nr. 32/2013 për: Organizimin e kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar

³⁸ Më tepër në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e organeve profesionale në këto procese shih Pjesa V, Seksioni 3: Roli i organeve profesionale të shkollës në zbatimin e kurrikulës

³⁹ Si më lart

Pjesa IV: Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës

Hyrje

Në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës janë definuar qartë prishmëritë në raport me proceset e mësimdhënies dhe nxënies. Një përmbledhje e kritereve të performancës në kuadër të kësaj fushe të cilësisë (përshkrimi i tyre dhe roli i udhëheqjes së shkollës dhe mësimdhënësve në përmbushjen e tyre) është dhënë edhe në Pjesën I të këtij doracaku⁴⁰.

Në pjesën në vijim do të fokusohemi në qasjen që duhet të ndjekë shkolla për të udhëhequr:

- Realizimin e proceseve mësimore në funksion të mëimit të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore;
- Përfshirjen e prindërve në proceset mësimore; dhe
- Vlerësimin i arritjeve të nxënësve dhe administrimi i rezultatave të vlerësimit.


1. Realizimi i procesit mësimor në funksion të mëimit të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore

Për të udhëhequr realizimin e procesit mësimor, në funksion të mëimit të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore, udhëheqja e shkollës duhet që fillimisht të kuptoj ndikimin e kurrikulës së re në rolin e mësimdhënësit dhe veçortitë e procesit mësimor.

Ndryshimi i rolit të mësimdhënësit mund të paraqitet figurativisht si më poshtë, dhe udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që ky ndryshim të reflektohet si duhet si në përshkrimin e detyrave të mësimdhënësve, ashtu edhe në mbikqyrjen, përkrahjen dhe vlerësimin e punës së tyre.

⁴⁰ Shih Pjesa (I), seksioni 3.3. Materiale të tjera të vëna në dispozicion nga MASHT për drejtorët e shkollave janë edhe:

- Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë: Udhëzues për Drejtorët e shkollave, MASHT, Prishtinë, 2012
- Doracak për mentorimin e mësimdhënësve: Udhëzues për drejtorët e shkollave, MASHT, Prishtinë, 2012 - Udhëzues për zbatimin e kurrikulës (material ndihmës për mësimdhënës), MASHT & IPK, Prishtinë, 2016



Në tabelën vijuese janë përshkruar kërkesat kryesore të kurrikulës në raport me realizimin e procesit mësimor dhe interpretimi i tyre me terma praktik, si referencë për monitorim dhe përkrahje të procesit mësimor nga udhëheqja e shkollës.

Kërkesat kryesore të kurrikulës	Sqarime/shembuj ilustrues të manifestimit në procesin mësimor
Krijimi i një klime përkrahëse pune, ku të gjithë nxënësit ndihen të respektuar, të mirëpritur dhe të lidhur me njëritjetrin, me mësuesin dhe me institucionin shkollor të cilit i përkasin.	Për çdo çështje që trajtohet gjatë një procesi mësimor, çdo fëmijë e ka një informatë paraprake, një emocion të caktuar apo një përvojë dhe nga ana tjetër një mundësi për të kontribuar. Mësuesi duhet të ketë konsideratë për këtë fakt në mënyrë që nxënësit të ndjehen të vlerësuar dhe të lirë që të shprehin qëndrimet dhe përvojat e tyre mbi çështjen përkatëse. Mbi këtë bazë duhet të ndërtoj tutje procesin mësimor.
Qasja e bazuar në kompetenca	Të gjithë mësuesit që zhvillojnë mësimin në një klasë të caktuar duhet të udhëhiqen nga kompetencat kryesore të përcaktuara me KB për shkollën përkatëse. Ky është kuadri i përbashkët i veprimtarisë së tyre dhe në çdo moment duhet të sigurohen që asnjë përvojë e nxënësve në klasë të mos cenojë zhvillimin e kompetencave kryesore.
Realizimi i proceseve të plota dhe të shumanshme mësimore që integrojnë dhe reflektojnë lidhjet dhe ndërvarësitë në jetën reale.	Të gjithë mësuesit që zhvillojnë mësimin në klasën përkatëse, në bazë javore duhet të identifikojnë pikat e përbashkëta të njësive mësimore që planifikohen për javën vijuese dhe mundësitë për integrim sa më të lartë ndërkurrikular.

	<p>Në një shkollë që ka përvetësuar këtë qasje, nuk është aspak e parëndomtë nëse në orë të edukatës fizike nxënësit dhe mësime të tjerë janë duke komunikuar në gjuhën angleze; apo nëse në një orë të artit figurativ është duke u punuar në paraqitjen vizuale të proceseve të caktuara shoqërore të cilat janë trajtuar në kuadër të shkencave shoqërore.</p>
<p>Organizimi i aktiviteteve mësimore, që marrin parasysh dallimet mes nxënësve (që kanë të bëjnë me stilet e ndryshme të të mësuarit dhe prirjet individuale të nxënësve);</p>	<p>Çdo nxënës mundet dhe duhet t'i arrij kompetencat kryesore të përcaktuara për shkollën përkatëse kurrikulare dhe rezultatet e të nxënësve të përcaktuara për fushat kurrikulare. Secili nxënës ka një pikë të fortë që duhet të identifikohet dhe të shfrytëzohet në mënyrë që të gjithë nxënësit të jenë të angazhuar dhe të vlerësuar për cdo aktivitet që zhvillohet.</p> <p>P. sh. me rastin e organizimit të një gare sportive në kuadër të edukatës fizike, të gjithë nxënësit mund të mos e kenë kondicionin dhe prirjen e caktuar për pjesëmarrje në garë, por sigurisht se ka nga ata që mund të bëjnë një shkrim për garën; nga ata që mund të përgatisin simbolin e ekipit, flamurin, pamfletat; ata që mund të organizojnë pjesëmarrjen e publikut dhe të ndjellin tifozët etj. Në këtë mënyrë të gjithë marrin pjesë aktive dhe kontribuojnë për realizim sa më të suksesshëm të këtij aktiviteti sportiv.</p>
<p>Zbatimi i qasjes dhe teknikave të të nxënësve aktiv</p>	<p>Diskutimet, debatet dhe angazhimi i nxënësve paraqesin thelbin e nxënies aktive. Në të nxënësve aktiv është e domosdoshme që mësime të tjerë të jetë partner në nxënies dhe t'i frymëzojë e përkrahë nxënësit për të zbuluar dhe për t'u angazhuar në një proces. Që të arrihet kjo, nxënësit duhet të jenë të informuar dhe të vetëdijshëm për arsyeshmërinë e çdo aktiviteti mësimor në të cilin marrin pjesë dhe për përgjegjësinë e tyre për përmirësim dhe sukses.</p>
<p>Përkrahje e individualizuar e secilit nxënës drejt progresit në përvetësimin e kompetencave kryesore dhe realizimit të potencialit të tyre;</p>	<p>Në rrethanat aktuale të shkollave tona kur punohet në së paku dy ndërrime, detyrat e shtëpisë janë mundësi shumë e mirë për angazhim të individualizuar të nxënësve në përputhje me nevojat, prirjet dhe mundësitë e secilit nxënës.</p>
<p>Vetëreflektim të vazhdueshëm nga ana e mësime të tjerë për efektivitetin e mësime të tjerë dhe qasje inovative në tejkalimin e sfidave;</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit, reflektimi i vazhdueshëm i mësime të tjerë për efektivitetin e proceseve mësimore dhe informatat kthyesë të nxënësve shfrytëzohen për të planifikuar dhe përshtatur proceset mësimore, për t'u ofruar nxënësve mbështetje të diferencuar drejt zotërimit të kompetencave kryesore dhe realizimit të potencialit të tyre si dhe për të ndihmuar prindërit që të mbështesin menaxhimin e progresit të nxënësve.</p>

Përfshirja e nxënësve në proceset mësimore është aspekti më i rëndësishëm i një mësimdhënie cilësore dhe pjesëmarrja aktive e nxënësve nuk mund të mungojë nëse gjatë proceseve mësimore respektohen kërkesat e lartpërmendura.

Prandaj, niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet tjera shkollore është treguesi më i rëndësishëm i performancës së shkollës.

Për të udhëhequr procesin e përmirësimit të praktikave mësimore nga drejtori i shkollës pritet që:

- T'i bëj të qarta pritshmëritë e reja nga mësimdhënësit;
- Të vlerësojë kapacitetin e mësimdhënësve për zbatimin e tyre dhe mbi këtë bazë të planifikojë zhvillimin profesional të mësimdhënësve, përfshirë edhe mentorimin kolegjial;
- Të monitorojë dhe vlerësojë ndikimin e ZhPM në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies;
- Të monitorojë nivelin e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset mësimore dhe proceset tjera të shkollës;
- Të monitorojë arritshmërinë e nxënësve në faza të ndryshme të vlerësimit të tyre;
- Të sigurojë funksionimin e rregullt të organeve profesionale dhe reflektim të vazhdueshëm nga ana e këtyre organeve për praktikën e mësimdhënies dhe mundësitë për përmirësim të proceseve mësimore⁴¹;
- Të përkrahë dhe monitorojë zbatimin e masave të propozuara nga organet profesionale për përmirësim të praktikave mësimore.

Kini parasysh

Përfshirja aktive e nxënësve në të gjitha proceset shkollore i kontribuon drejtpërdrejtë zhvillimit të të gjitha kompetencave, ndërsa pjesëmarrja e nxënësve është rezultat i një performace të mirë të shkollës

⁴¹ Shih Pjesa II, seksioni 3.

2. Përfshirja e prindërve në procesin mësimor

Roli i prindërve në performancën akademike, sociale e personale të fëmijëve është i padiskutueshëm, prandaj shkolla duhet të angazhohet shumë më tepër për përfshirjen e prindërve në procesin mësimor dhe në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve të tyre.

Pikërisht për këtë arsye, niveli i përfshirjes së prindërve përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të vlerësimit të performancës së shkollës.

Përfshirja e prindërve në shkollë mund të shihet nga dy perspektiva:

- nga perspektiva e përfshirjes së prindërve në përkrahjen e iniciativave të ndryshme të shkollës dhe në vendimmarrjet që bëhen në nivel shkolle dhe
- nga perspektiva e përfshirjes së prindërve në shkollë dhe në shtëpi për çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mbështetjen e fëmijës së tyre në zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të tyre.

Sa i përket aspektit të dytë të përfshirjes, prindërit kanë brengosje legjitime për atë se çka mësimdhënësit bëjnë me fëmijët e tyre:

- Çfarë influence do të kenë mësimdhënësit te fëmija i tyre, të mirë apo të keqe?
- A do ta nxisin fëmijën që të mësojë?
- A do ta ndihmojnë fëmijën të mësojë?
- A do të pëlqehen nga fëmija?
- A do ta ndihmojnë mësimdhënësit fëmijën që të zhvillojë një nivel të pranueshëm të disiplinës dhe sjelljes?

Kini parasysh!

Për një partneritet të suksesshëm, modelet e përfshirjes së prindërve duhet t'u përshtaten mundësive familjare apo t'i marrin në konsideratë pikëpamjet e prindërve për këtë partneritet

Nga ana tjetër, edhe mësimdhënësit kanë një brengë legjitime për atë që prindërit bëjnë me fëmijët e tyre pasi ata të jenë kthyer në shtëpi:

- Çfarë lloj mjedisi familjar i ofrohet fëmijës?
- A do të sigurojnë prindërit që fëmija t'i përfundoj^ detyrat e shtëpisë?
- A do të jenë prindërit kritik ndaj metodave disiplinore të mësimdhënësve?
- A do të kenë prindërit pritshmëri të larta nga mësimdhënësit, me theks të veçantë në korrigjimin e problemeve në sjellje të cilat fëmija i zhvillon në shtëpi?

Bazuar në përvojat e deritanishme të shkollave tona, modelet e përfshirjes së prindërve kryesisht kërkojnë nga prindërit që t'i përshtaten praktikës së institucionit shkollor.

Nga ana tjetër, përfshirja e prindërve kërkon përpjekje të shtuar nga ana e mësimit dhe prindërve, të cilët në rutinën e tyre të përditshme duhet ta kenë të planifikuar këtë angazhim. Prandaj, ju duhet të keni parasysh se përkundër faktit se bashkëpunimi me prindër është i domosdoshëm për të siguruar një arritje sa më të lartë të fëmijës, efektiviteti i formave të ndryshme të përfshirjes së prindërve nuk është eksploruar sa duhet (pra efektiviteti i një forme të bashkëpunimit krahasuar me një tjetër).

Zgjedhjet e institucioneve shkollore për partneritet (format e partneritetit) duhet t'i përshtaten nevojave dhe mundësive të komunitetit specifik të prindërve të shkollës përkatëse apo/dhe nevojave dhe mundësive të secilit prind.

Po ashtu, format e bashkëpunimit që përzgjedhen nga shkolla duhet të jenë kuptimplota, të përshtatshme dhe me qëllim të qartë për të dyja palët. Në tabelën vijuese janë dhënë disa nga funksionet kryesore të prindërve në raport me performancën e nxënësve dhe është përshkruar roli i shkollës në përkrahjen e prindërve për përmbushjen e këtyre funksioneve dhe rritjen e bashkëpunimit me shkollën.

Roli i prindërve Si mund të kontribuojë shkolla?

Përmbushja e obligimeve prindore

Ofrimi i programeve të këshillimit të prindërve për shkathtësitë prindërore në përkrahjen e fëmijëve të tyre gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit.

Vendosja e partneritetit me ofrues tjerë të shërbimeve me qëllim të përkrahjes së familjeve për tejkalimin e krizave ekonomike – sociale që mund të jenë barriera për vijueshmërinë dhe arritshmërinë e nxënësve⁴².

Komunikimi

Ndërtimi i kanaleve efektive të komunikimit ndërmjet shkollës dhe familjes për programet shkollore dhe progresin e nxënësve. Këto forma mund të përfshijnë:

- Kontakte të drejtpërdrejta individuale dhe grupore,
- Revistën e shkollës,
- Postën elektronike,
- Uebfaqen
- Telefonatat, etj

⁴² Shkollat tona kanë përvojë të ndryshme të organizimit për përkrahje të nxënësve në nevojë dhe familjeve të tyre për tejkalimin pengësive të vijueshmërisë dhe arritshmërisë së nxënësve. Përderisa deri më tani këto organizime janë bërë në formë solidariteti, tani është obligim i shkollës që t'i identifikojë këto barriera dhe të provoj zgjidhje të ndryshme për tejkalimin e tyre. Zgjidhjet mund të jenë nga organizimi i vet nxënësve për përkrahjen e moshatarëve të tyre, për të vazhduar me mundësitë e organizimit të prindërve e deri te identifikimi i partnerëve të mundshëm jashtë shkolle nga udhëheqja e shkollës. Cilado nga këto zgjidhje (apo edhe të tjera) është e mundur vetëm nëse shkolla nga njëra anë i identifikon dhe dokumenton këto barriera dhe sensibilizon akterët e ndryshëm që mund të kontribuojnë dhe nga ana tjetër ka dëshmuar një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe transparencës në shfrytëzimin e fondeve eventuale për përkrahjen e këtyre iniciativave.

Angazhimi vullnetar	Evidentimi i mundësive të prindërve për të kontribuar në shkollë (një gjë e tillë mund të evidentohet edhe me rastin e regjistrimit të fëmijës në shkollë) Angazhimi i familjeve në procese të ndryshme të punës së shkollës, konform mundësive të tyre.
Përkrahja e nxënësve në detyrat e shtëpisë	Inkurajimi i përfshirjes së prindërve në përcjelljen e progresit të fëmijëve të tyre, vendosjen e qëllimeve për të nxënë dhe realizimin e detyrave shtëpiake. Përfshirja e prindërve në përkrahjen e fëmijëve të tyre drejt zotërimit të kompetencave kryesore dhe realizimit të potencialit të tyre.
Vendimmarrja	Sigurimi i pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të prindërve në proceset vendimmarrëse në nivel klase Sigurimi i përfaqësimit të denjë të prindërve në proceset vendimmarrëse në nivel shkolle përmes organeve qeverisëse të shkollës (Këshillin e prindërve dhe Këshilli drejtues)

Për vendosjen e mekanizmave efektiv të komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me prindër, udhëheqja e shkollës fillimisht duhet të analizojë situatën aktuale.

Për këtë qëllim, në konsultim me mësimdhënës dhe me prindër duhet të konstatohet si vijon:

- A ka shkolla mundësi praktike për realizimin e partneritetit me prindër (hapësirë për takime, fond të orëve në dispozicion nga mësuesit dhe/apo personeli tjetër i shkollës, fleksibilitet sa i përket formave të bashkëpunimit, procedura të qarta të bashkëpunimit).
- A ofron shkolla programe të përkrahjes së prindërve në përmirësimin e shkathtësive të tyre prindore? Cilat janë mundësitë e shkollës për të ofruar këtë shërbim? Si mund të realizohet një gjë e tillë?
- Si e administron shkolla angazhimin vullnetar të prindërve? Si evidentohen mundësitë e prindërve për të kontribuar në proceset e shkollës? Si dhe nga kush shfrytëzohet ky informacion?
- Cilat janë procedurat e ankesave të prindërve? Si dhe nga kush shqyrtohen ato? Si dhe nga kush ofrohen informatat kthyesë për prindërit?
- Cilat forma të bashkëpunimit mësimdhënës-prind aplikohen në shkollën tuaj për të siguruar një arritje sa më të lartë të fëmijës (takime individuale, komunikim individual përmes telefonit/e-mailit/letrave, forma grupore me një grup të prindërve apo me të gjithë prindërit e klasës)?
- Sa janë ato efektive? Cili është niveli i pjesëmarrjes së prindërve?

- Nëse nuk janë efektive, pse nuk janë dhe si mund të përmirësohet efektiviteti i tyre?
- Cili është niveli i pjesëmarrjes së prindërve në vendimmarrje?
- Cilat janë mundësitë për përfshirjen e prindërve në mobilizimin e resurseve të nevojshme për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik të shkollës dhe pasurimin e burimeve mësimore?
- A janë mësimdhënësit të përgatitur dhe a e kanë mbështetjen e duhur nga shkolla për të zhvilluar një bashkëpunim cilësor me prindërit?
- Cilat janë barrierat tjera që pengojnë bashkëpunimin me prindër dhe si mund të tejkalohen ato?

Kini parasysh!

Ky investim i shkollës në masë të madhe i kontribuon cilësisë dhe nivelit të performancës së saj në raport me arritshmërinë e nxënësve, prandaj duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur.

Mbi këtë bazë shkolla, në konsultim me prindërit, duhet t'i planifikojë dhe zbatojë masat e nevojshme për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me prindër.

3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve dhe administrimi i rezultateve të vlerësimit

a. Format e vlerësimit të nxënies në nivel shkolle

Orientimet e përcaktuara me Kornizën Kurrikulare për sistemin e vlerësimit të nxënësve vendosin fokusin në vlerësimin e vazhdueshëm të nivelit të arritshmërisë së kompetencave kryesore. Vlerësimi formativ (për nxënie) është komponentë shumë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe nxënies dhe MASHT ka vënë në dispozicion për drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit një udhëzues që përshkruan veçoritë e këtij vlerësimi, rolin e mësimdhënësve, nxënësve, drejtorëve të shkollave dhe prindërve në vlerësimin për nxënie, parimet dhe strategjitë e zbatimit të tij dhe mundësitë e shfrytëzimit me rastin e planifikimit të procesit mësimor⁴³.

Siç është përshkruar në tabelën vijuese, sistemi i vlerësimit të rezultateve të nxënies i përcaktuar në sistemin e kurrikulës definon se *çka* vlerësohet, *kur*, *si* dhe *nga kush* realizohen format e ndryshme të vlerësimit të nxënies në nivel shkolle.

⁴³ Vlerësimi formativ, BEP- MASHT, 2013. BEP në bashkëpunim me MASHT, po ashtu ka përgatitur udhëzuesin: Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca (udhëzues për mësimdhënësit), korrik 2016.

Dokumentet e kurrikulës	Çka vlerësohet?	Llojet e vlerësimit dhe periudha e realizimit	Bartësit	Qëllimet kryesore sipas llojeve të vlerësimit	Dokumentimi/ evidentimi i arritjeve në vlerësim
PROGRAMET mësimore për klasë	Rezultatet e të nxënimit të përcaktuara në kuadër të programeve shkollore për çdo temë mësimore në kuadër të secilës lëndë dhe të planifikuara për një periudhë të caktuar mësimore	Vlerësimi i vazhdueshëm - Bëhet gjatë procesit të të nxënimit (<i>vlerësimi formativ</i>), dhe - Në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimimit (<i>vlerësimi përmbledhës⁴⁴</i>)	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	- Mbështetja e të nxënimit të nxënësve; - Informimi dhe raportimi - Vendosja e notes në fund të një periudhe mësimore; - Informimi dhe raportimi; - Planifikimi për mbështetjen e vazhdueshme të nxënimit të nxënësve.	- Evidencimi në notesin e punës së mësim dhënësit; - Evidencimi në libër të klasës i notave për periudhat e caktuara të vitit mësimor/ dhe apo ditarin elektronik; - Portfolio e nxënësit
PROGRAMET mësimore për klasë	Rezultatet e të nxënimit të përcaktuara në kuadër të programeve lëndore	Vlerësimi përfundimtar Bëhet në fund të vitit mësimor/ vitit shkollor.	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse.	- Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor ⁴⁵ - Informimi dhe raportimi - Planifikimi për mbështetjen e të nxënimit të nxënësve në vitin vijues.	Në arsimin bazik, (klasët përgatitore, I deri V) notat përfundimtare evidencohen në librin e klasës dhe në librin amë/ dhe/apo në ditarin elektronik, si dhe në librezën e nxënësit. Në nivelet tjera, notat përfundimtare evidencohen në librin e klasës, në librin amë/ dhe/apo në ditarin elektronik, si dhe në dëftesën për klasë (në fund të klasave VI, VII, VIII, IX, X, XI dhe XII).

⁴⁴ Sipas Udhëzimit administrativ për vlerësimin e nxënësve, nota e vlerësimit të vazhdueshëm për një periudhë të caktuar kohore për nxënësit e klasave nga 6 – 12 formohet prej dy vlerësimeve përmbledhëse [VP1, VP2]:

(i) Vlerësimi përmbledhës 1 (VP1). Nota e vlerësimit përmbledhës formohet nga evidencat e angazhimit në klasë, nga detyrat e shtëpisë, kuizet, debatet, prezantimet me gojë, esetë, testet, portofoliot, projektet dhe nga puna në kabinet. Puna e nxënësit për kapituj apo njësi të caktuara vlerësohet me notë e cila mund të shoqërohet edhe me komente.

(ii) Vlerësimi përmbledhës 2 (VP2). Nota e vlerësimit përmbledhës në fund të një periudhe të caktuar kohore del nga rezultati që kanë arritur nxënësit përmes një instrumenti vlerësues, (i cili përcaktohet në planifikimin e vlerësimit të aktiveve profesionale), varësisht nga specifikat e fushës/lëndës mësimore.

⁴⁵ Nota përfundimtare e një lëndë mësimore reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor. Nota përfundimtare formohet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzimin administrativ për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së re.

KURRIKULAT BËRTHAMË	Rezultatet e të nxënësve që shprehin nivelin e arritshmërisë së kompetencave në fund të një shkollë	Vlerësim për shkollë ⁴⁶ Realizohet në fund të çdo shkollë kurrikulare, përkatësisht në përfundim të klasave: 2, 5, 7 dhe 11.	Ekipi profesional/këshilli i mësimdhënësve të cilët kanë realizuar programin mësimor brenda një shkollë kurrikulare ⁴⁷	Verifikimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe zotërimi i kompetencave kryesore në nivel të një shkollë dhe fushe kurrikulare.	Evidencimi përshkrues në librin e klasës – në faqet e veçanta për vlerësimin në fund të çdo shkollë të kurrikulës ⁴⁸ .
	Rezultatet e të nxënësve sipas fushave kurrikulare, për secilën shkollë kurrikulare	(vlerësimi i jashtëm në fund të klasës 9 dhe klasës 12, e mbulon vlerësimin për shkollën e kurrikulës 4 dhe 6)		Planifikimi për mbështetjen e të nxënësve në vitin vijues; Informim dhe raportim për prindërit dhe për institucionet arsimore; Diplomimi në shkollën e mesme të lartë (arsimin e përgjithshëm)	Në raportet përmbledhëse të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasës Në klasën XII në diplomë të arsimit të përgjithshëm / certifikatë të provimit të maturës.

Në një sistem arsimor që si orientim ka qasjen e bazuar në kompetenca, arritshmëria e nxënësve është aspekti më i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe të shkollës.

Prandaj, strukturat e menaxhimit të shkollës, proceset e mësimdhënies dhe ato të përkrahjes së nxënësve duhet të rishikohen vazhdimisht nga perspektiva e impaktit në ngritjen e performancës së nxënësve.

⁴⁶ Është vlerësim i standardizuar dhe bëhet në dy mënyra: (a) Me teste të përgatitura nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT dhe të menaxhuara nga shkolla, dhe (b) Me teste të përgatitura dhe të menaxhuara nga vet autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT ose ndonjë institucion tjetër i përcaktuar nga MASHT-i. Rezultatet e këtij vlerësimi analizohen në nivel shkolle dhe krahasohen me evidencat e vëna në dispozicion nga mësimdhënësit që e mbulojnë fushën kurrikulare për të dëshmuar progresin e secilit nxënës, secilës klasë dhe shkollës në përgjithësi. Evidencat duhet të jenë të dokumentuara në portfoliot e nxënësve dhe të prezantohen edhe në raportin vjetor të shkollës. Vlerësimi për shkollën e 6-të, përkatësisht klasën e XII-të ndërlidhet me vlerësimin e jashtëm – provimin e maturës shtetërore.

⁴⁷ Më gjerësisht për Vlerësimin për shkollë, shih udhëzuesin: Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca (Udhëzues për mësimdhënës, korrik 2016). Programi për Arsimin Themelor (Basic Education Program) i USAIDit.

⁴⁸ Përshkrimi i vlerësimit në fund të shkollës mbështetet në evidencat dhe në mestaren e arritjeve në testin standardizuar, sipas përcaktimeve në UA nr. 08/2016: Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë.

b. Administrimi i rezultateve të vlerësimit

Shfrytëzimi i rezultateve të vlerësimit për të përcjellë trendin e arritshmërisë së nxënësve në nivel shkolle dhe për të avansuar proceset e mësimdhënies dhe punës së përgjithshme të shkollës kërkon vendosjen e një sistemi efektiv të administrimit të rezultateve të vlerësimit të nxënësve në të gjitha nivelet; pra një sistem të analizës dhe shfrytëzimit të tyre nga organet përkatëse të shkollës.

Në tabelën vijuese janë paraqitur llojet kryesore të vlerësimit të nxënësve në nivel shkolle dhe kuadri/organet përgjegjëse për administrimin e tyre.

Llojet e vlerësimit	Kuadri/organet përgjegjëse për administrimin e rezultateve	Intervalet kohore të raportimit ⁴⁹	Funksioni i raporteve
Vlerësimi i vazhdueshëm	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	Në fund të çdo teme mësimore nxënësit duhet të vlerësohen me notë dhe mësimdhënësit duhet të përgatisin një raport përmbledhës të arritshmërisë së nxënësve me të cilat është realizuar ajo temë.	Këto raporte prezantohen dhe diskutohen me kolegët në aktivin profesional dhe në takimet e rregullta të këshillit të klasës.
		Raportet individuale të mësimdhënësve përgatiten edhe në fund të çdo periudhe mësimore ⁵⁰ për secilën klasë në të cilën mësimdhënësi përkatës ka zhvilluar mësim. Në bazë të diskutimeve, AP përgatit një raport të përgjithshëm për suksesin dhe progresin e nxënësve gjatë gjysmëvjetorit përkatës, faktorët që kanë ndikuar në këtë performancë të nxënësve dhe hapat e mëtejshëm.	Raporti i AP shfrytëzohet me rastin e planifikimit të gjysmëvjetorit për periudhën vijuese.

⁴⁹ Është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit për nevoja vetanake të praktikojnë vetëreflektimin mbi proceset e mësimdhënies në bazë të rregullt; në çdo situatë kur niveli i pjesëmarrjes së nxënësve nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe kur arritshmëria e nxënësve në rezultatet e vlerësimit nuk është e kënaqshme. Mbi këtë bazë, mësimdhënësit duhet të planifikojnë zgjidhje të reja për t'i adresuar faktorët të cilët kanë ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. Raportet e vetëreflektimit të vazhdueshëm mbahen në dosjen personale të mësimdhënësit.

⁵⁰

Vlerësimi përfundimtar	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse	<p>Vlerësimi përfundimtar në një lëndë mësimore realizohet në nivel klase si vlerësim i përfundimit të vitit mësimor i nxjerrë nga mesatarja aritmetike e tri periudhave të caktuara mësimore</p> <p>Raportet e KK përgatiten në bazë të suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor.</p>	<p>Këto raporte shfrytëzohen për të analizuar praktikat e mësimdhënies gjatë vitit shkollor, efektivitetin e punës së KK dhe për të planifikuar masat e nevojshme për përmirësim në vitin vijues.</p>
Vlerësimi i arritshmërisë në zotërimin e kompetencave në fund të Shk	Aktivet profesionale Këshillat e klasave	<p>Raportet e AP përgatiten në fund të çdo shkalle kurrikulare.</p> <p>Raportet e KShK në fund të çdo shkalle kurrikulare.</p>	<p>Ky vlerësim ka rol diagnostikues dhe si i tillë ka për qëllim verifikimin e arritjes së rezultateve të të nxënësve nga nxënësve në nivel shkalle kurrikulare të fushave përkatëse në kontekstin e zotërimit të kompetencave kryesore, si dhe, mbi këtë bazë, organizimin e mësimdhënies për progres të vazhdueshëm të shkallës së arritshmërisë. Shfrytëzohet për të vlerësuar programin mësimor, praktikat e mësimdhënies, efektivitetin e AP gjatë një shkalle kurrikulare dhe performancën e përgjithshme të shkollës.</p>

Në Shtojcën 9 është dhënë një tabelë që mund ta shfrytëzoni si orientim për analizën e rezultateve të vlerësimit, identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në performancën e nxënësve dhe planifikimin e masave për përmirësim.

Pjesa V: Roli i udhëheqjes së shkollës në menaxhimin efektiv të procesit të zbatimit të kurrikulës

Hyrje në rolin e udhëheqjes së shkollës në menaxhimin efektiv të procesit të zbatimit të kurrikulës

Personeli udhëheqës i shkollës është përgjegjës për performancën arsimore të shkollës, respektivisht për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe për avancimin e arritshmërisë së nxënësve. Prandaj,

cilësia e menaxhimit të shkollës ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e procesit të zbatimit të kurrikulës së re shtetërore, sidomos në fazat e para të procesit.

Kurrikula e re siguron nivel të rritur të autonomisë së shkollës për të planifikuar dhe realizuar zbatimin e kurrikulës në pajtim me kushtet specifike të kuadrit të saj mësimor, infrastrukturën e shkollës dhe karakteristikat lokale ku funksionon shkolla. Si e tillë, kurrikula e re i mundëson secilës shkollë të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve dhe lokalitetit ku funksionon. Por,

për aq sa rritet autonomia e shkollës për aq rritet edhe përgjegjësia e udhëheqjes së shkollës për të siguruar se kjo autonomi shfrytëzohet brenda frymës dhe kërkesave të përcaktuara me KKAP dhe Kurrikulat Bërthamë, si dhe në interesin më të mirë të nxënësve dhe lokalitetit ku vepron.

Nga ana tjetër, qasja e bazuar në kompetenca kërkon ndryshim fundamental të mënyrës së ndërveprimit ndërmjet palëve që e përbëjnë komunitetin shkollor.

Kjo nënkupton,

kultivimin e një kulture organizative të shkollës, e cila i kushton vëmendjen e duhur përfshirjes së nxënësve dhe prindërve në proceset shkollore, përfshirjes së ekspertëve të jashtëm, bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve dhe të mësimdhënësve me lidërsipin e shkollës, bashkëpunimit me shkollat tjera, partnerët dhe ofruesit tjerë të shërbimeve si dhe reflektimit të vazhdueshëm mbi efektivitetin e praktikave të mësimdhënies dhe organizimit të shkollës.

1. Roli i drejtorit të shkollës në zbatimin e kurrikulës

Roli i drejtorit të shkollës shtrihet në të gjitha dimensionet e punës së shkollës. Shtrirja e përgjegjësive kryesore të drejtorit të shkollës në kuadër të Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është paraqitur në tabelën vijuese⁵¹.

⁵¹ Në mënyrë më të detajuar detyrat e Drejtorit të shkollës janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 04/2012 Për standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollës, ndërsa roli i udhëheqjes së shkollës për zbatimin e kurrikulës në kuadër të secilit kriter të performancës është elaboruar në Pjesa I, seksioni 3.

Çka pritet nga drejtori i shkollës?

Funksioni kryesor i drejtorit të shkollës në raport me zbatimin e kurrikulës ka të bëjë me udhëheqjen e ndryshimit.

Për të udhëhequr ndryshimin brenda frymës dhe kërkesave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës, drejtori i shkollës duhet që fillimisht ta kuptoj^ ndryshimin dhe ndikimin e tij në punën e përgjithshme të shkollës.

Për këtë qëllim, fillimisht duhet të analizohen me shumë kujdes:

- Korniza e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar në Kosovë dhe KB,
- Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës,
- Treguesit e performancës së shkollës dhe
- Pjesa I e këtij doracak.

Kjo pako e materialeve ofron kuadrin e përgjithshëm konceptual të ndryshimit, përshkruan rolin e ri të shkollës, pritshmëritë e përgjithme nga shkolla dhe treguesit e performancës, të cilët duhet të shërbejnë si orientim për planifikimin dhe vlerësimin e të gjitha intervenimeve në nivel shkollë për zbatimin e kurrikulës⁵².

Materiale të tjera që janë përpiluar për të mbështetur drejtorët e shkollave në zbatimin e kurrikulës janë edhe:

- Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë: Udhëzues për Drejtorët e shkollave, SËAP-MAShT, Prishtinë, 2012,
- Doracak për mentorimin e mësimdhënësve: Udhëzues për drejtorët e shkollave, SËAP-MAShT, Prishtinë, 2012.
- Udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës (materiale ndihmës për mësimdhënës), MASHT & IPK, Prishtinë, 2016.

Hapat kryesorë që duhen të ndërmerren nga udhëheqja e shkollës, në kuadër të përgatitjeve për zbatimin e kurrikulës së re si dhe aspektet më të rëndësishme të zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të praktikave shkollë janë trajtuar në Pjesët II-IV.

⁵² Drejtori i shkollës nuk duhet të ketë asnjë dilemë sa i përket pritshmërive të definuara me Kornizën e vlerësimit të performancës së shkollës dhe treguesit e vlerësimit, prandaj për çdo paqartësi duhet të kontaktojë me zyrtarin përgjegjës në DKA, IPK-në apo me Divizionin përkatës në MAShT.

2. Roli i organeve tjera qeverisëse në zbatimin e kurrikulës

Këshilli Drejtues i shkollës

Këshilli drejtues i shkollës është organi më i lartë këshilldhënës dhe vendimmarrës në shkollë⁵³. Në mënyrë që shkolla të funksionojë si organizatë e suksesshme, roli i këshillit drejtues të shkollës është qenësor në:

- mbikëqyrjen e funksionimit të shkollës dhe cilësisë së shërbimeve që ofrohen për nxënësit,
- sigurimin e llogaridhënies në shkollë,
- përkrahjen e drejtorit për zhvillimin e shkollës drejt objektivave të përcaktuara nga shkolla dhe komuniteti.

Për përbërjen, funksionin dhe funksionimin e KDSH mund të informoheni përmes materialeve të përgatitura për këtë qëllim⁵⁴.

Për të ushtruar rolin e vet në funksion të zbatimit të kurrikulës anëtarët e KDSH duhet ta kuptojnë ndryshimin që sjell fryma e re e kurrikulës dhe ndikimin e saj në punën e përgjithshme të shkollës.

Për këtë qëllim, fillimisht duhet të analizohen me shumë kujdes:

- Korniza e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar në Kosovë dhe KB
- Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës
- Treguesit e performancës së shkollës dhe
- Pjesa (I) e këtij doracaku

Mbi këtë bazë KDSH duhet të rishikojë rolin dhe funksionin e tij në procesin e zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit të performancës së shkollës; këto funksione duhet të jenë pjesë e statutit dhe rregullores së punës së KDSH.

Këshilli i Nxënësve

Këshilli i nxënësve është një ndër organet qeverisëse të shkollës përmes të cilit mundësohet komunikimi formal i shkollës me nxënësit. Funksioni kryesor i Këshillit të Nxënësve është përfaqësimi i interesave të nxënësve në këshillin drejtues të shkollës dhe tek drejtori i shkollës. Çështjet kryesore të cilat trajtohen nga KN, por jo vetëm, janë:

⁵³ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011. Neni 17, pika 1. “Çdo institucion publik arsimor dheaftësues duhet të ketë këshillin drejtues...”

⁵⁴ Doracak për Këshillin Drejtues të Shkollës, BEP-MAShT, 2012 dhe Seminari pesë, Bashkëpunimi dhe zhvillimi i shkollës, GIZ-MAShT, fq.15-18.

- performanca e përgjithshme e shkollës dhe mësimdhënësve,
- mjedisi shkollor,
- çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve dhe
- shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e nxënësve.

Proceset e qeverisjes demokratike të shkollës, përfshirë funksionimin e Këshillit të Nxënësve, i kontribuojnë drejtpërdrejt zhvillimit të kompetencës së qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme prandaj, ato nuk duhet të realizohen në mënyrë formale sa për të përmbushur një obligim ligjor; këto procese duhet ta kenë vëmendjen e duhur dhe të jenë kuptimplota për nxënësit.

Kjo arrihet duke i përgatitur dhe përkrahur nxënësit për të ushtruar të drejtën dhe përgjegjësinë e tyre të pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse të shkollës dhe në përmirësimin e performancës së shkollës në të gjitha dimensionet e veprimtarisë së saj.

Për të ushtruar funksionin e vet anëtarët e Këshillit të Nxënësve duhet të jenë të informuar për kuadrin rregullativ brenda të cilit vepron shkolla. Për këtë qëllim ata duhet të analizojnë:

- Kornizën për vlerësimin e performancës së shkollës,
- Treguesit e performancës së shkollës dhe
- Pjesën (I) të këtij doracaku.

Mbi këtë bazë ata duhet të rishikojnë rolin dhe funksionin e tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimin e performancës së shkollës në kuadër të secilit dimension; të përcaktojnë detyrat që duhet të realizohen nga KN në përkrahje të ndryshimeve të filluara nga shkolla për jetësimin në praktikë të kërkesave të kurrikulës së re.

Drejtori i shkollës duhet të përfshijë aktivisht Këshillin e nxënësve në udhëheqjen e ndryshimeve në nivel shkolle.

Këshilli i Prindërve

Këshilli i prindërve është një ndër organet qeverisëse të shkollës përmes të cilit mundësohet përfaqësimi i prindërve në këshillin drejtues të shkollës dhe tek drejtori i shkollës.

Çështjet kryesore të cilat trajtohen nga KP, por jo vetëm, janë:

- performanca e përgjithshme e shkollës dhe mësimdhënësve,
- mjedisi shkollor,

- çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve,
- shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e prindërve.

Për të ushtruar funksionin e vet anëtarët e Këshillit të prindërve duhet të jenë të informuar për kuadrin rregullativ brenda të cilit vepron shkolla.

Për këtë qëllim ata duhet të analizojnë:

- Kornizën për vlerësimin e performancës së shkollës,
- Treguesit e performancës së shkollës dhe
- Pjesën I të këtij doracaku.

Mbi këtë bazë ata duhet të rishikojnë rolin dhe funksionin e tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës dhe përmirësimit të performancës së shkollës në kuadër të secilit dimension.

Në këtë mënyrë ata mund t'i kontribuojnë edhe procesit të monitorimit të performancës së shkollës në zbatimin e kurrikulës dhe përmirësimit të kësaj performance përmes:

- angazhimit të tyre në procesin e zbatimit,
- reflektimeve kritike për praktikat shkollore dhe
- propozimit të zgjidhjeve dhe ndryshimeve që adresojnë interesat e nxënësve nga perspektiva e prindërve.

3. Roli i organeve profesionale të shkollës në zbatimin e kurrikulës

Në raport me procesin e zbatimit të kurrikulës, roli i organeve profesionale të shkollës është shumë i rëndësishëm për të siguruar bashkëpunimin e kuadrit mësimor me rastin e planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të proceseve mësimore dhe performancës së nxënësve.

Organet profesionale të shkollës janë:

- Këshilli i mësimdhënësve,
- Këshillat e klasave dhe
- Aktivitetet profesionale.

Në tabelën vijuese është propozuar roli i secilit organ profesional të shkollës për zbatimin e kurrikulës.

Organet profesionale	Përbërja dhe udhëheqja	Roli në zbatimin e kurrikulës	Kryesimi dhe Intervalet e takimeve ⁵⁵
Këshilli i mësimdhënësve (KM)	Gjithë kuadri mësimor dhe profesional i shkollës	KM miraton planet dhe programet mësimore të përpiluara nga KShK-të dhe KK-të. Diskuton raportet vjetore të punës së Këshillave të Shkallëve Kurrikulare, Këshillave të Klasave dhe Aktiveve profesionale, përfshirë: arritjet kryesore, sfidat e evidentuara dhe zgjidhjet e mundshme për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies dhe përmirësimit të performancës së shkollës në të gjitha dimensionet e veprimtarisë.	Kryesohet nga Drejtori i shkollës Takimet e rregullta: së paku një herë në vit
Këshillat e klasave (KK)	Kuadri mësimor i cili zhvillon mësim në klasën përkatëse	Këshillat e klasave: <ul style="list-style-type: none"> - Hartojnë dhe propozojnë planin për zhvillimin e kompetencave kryesore gjatë shkollës përkatëse kurrikulare dhe - Hartojnë dhe propozojnë planin mësimor për shkallë kurrikulare - Organizojnë dhe monitorojnë procesin e vlerësimit të arritshmërisë së kompetencave në fund të shkollës kurrikulare - Përpilojnë planin mësimor për një vit shkollor, në bazë të planit për shkallë kurrikulare dhe programeve mësimore për realizimin e fushave kurrikulare gjatë klasës përkatëse; - Monitorojnë dhe raportojnë për zbatimin e planit vjetor mësimor dhe impaktin e tij në performancën e nxënësve; - Përpilojnë programin mësimor për një vit shkollor (KK parafillore-V); - Përpilojnë planet javore të punës; - Diskutojnë zbatimin e planeve dhe programeve javore mësimore; 	Kryesuesi caktohet nga anëtarët e KK Takimet e rregullta: <ul style="list-style-type: none"> - Së paku dy herë në vit për proceset e planifikimit mësimor për shkallë kurrikulare dhe, vit shkollor dhe gjysëmvetor - një herë në javë për planet javore

⁵⁵ Intervalet e takimeve janë propozuar për takimet e rregullta të këtyre organeve; kjo nuk përjashton mundësinë e takimeve të tyre sipas nevojës, me kërkesë të kryesuesit apo të anëtarëve kurdo që një gjë e tillë është e nevojshme, sidomos në fazat e para të zbatimit të kurrikulës.

		<ul style="list-style-type: none"> - Identifikojnë zgjidhje për shfrytëzim sa më efektiv të fondit të orëve në dispozicion - Identifikojnë mundësitë për integrim ndërkurrikular të proceseve mësimore; - Reflektojnë në bazë javore për praktikat e mësimdhënies dhe mundësitë për përmirësim të proceseve mësimore. 	
Aktivet/ Departamentet profesionale (AP)⁵⁶	Ekipi i mësimdhënësve të fushave kurrikulare në klasat përkatëse të shkollës kurrikulare	Aktivet profesionale: <ul style="list-style-type: none"> - Përpilojnë programin mësimor; - Koordinojnë dhe monitorojnë procesin e zbatimit të programeve mësimore dhe impaktin e tyre në performancën e nxënësve; - Realizojnë vlerësimin përmbyllës të arritshmërisë së rezultateve të FK; - Identifikojnë faktorët që rrezikojnë zotërimin e rezultateve të fushave kurrikulare dhe zgjidhjet e mundshme për evitimin e tyre; 	Kryesuesi caktohet nga anëtarët e AP Takimet e rregullta: së paku një herë në dymuaj

Secili organ profesional duhet të ketë kryesuesin. Përgjegjësitë e kryesuesit janë:

- Organizimi i takimeve,
- Udhëheqja e takimeve,
- Ndarja e përgjegjësive për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara,
- Monitorimi i zbatimit të planeve të përpiluara,
- Mbajtja e evidencës së pjesëmarrjes, proces verbaleve dhe raporteve mbi zbatimin e planeve të përpiluara,
- Raportimi të udhëheqja e shkollës për mbarëvajtjen e punës dhe performancën e organit profesional⁵⁷.

Drejtori i shkollës mbikëqyr punën e organeve profesionale dhe siguron funksionimin e efektiv të këtyre organeve.

⁵⁶ Me gjerësisht për sistemin e aktiveve (departamenteve) profesionale në shkolla, organizimin, llojet, detyrat dhe përgjegjësitë, shih UA nr. 22/2016: Aktivet (Departamentet) profesionale në shkolla.

⁵⁷ Intervalet e raportimeve të rregullta duhet të përcaktohen në Rregulloret e punës së organeve profesionale. Rregullorja e punës duhet të propozohet në takimet konsoliduese të këtyre organeve dhe të miratohet nga Drejtori i shkollës.

4. Roli i shërbimeve profesionale të shkollës

Roli kryesor i shërbimeve profesionale të shkollës⁵⁸ është mbikëqyrja dhe përkrahja e mësimdhënësve në zbatimin e praktikave mësimore sipas kërkesave të kurrikulës. Këto shërbime duhet të:

- Mbikëqyrin në mënyrë të vazhdueshme performancën e kuadrit mësimor, identifikojnë nevojat për përkrahje, planifikojnë dhe sigurojnë mbështetjen e nevojshme profesionale;
- Inicojnë dhe mentorojnë bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet mësimdhënësve dhe planifikimin e përbashkët të proceseve mësimore;
- Identifikojnë mundësitë për përmirësimin e nivelit të komunikimit dhe bashkëpunimit me familjen;
- Identifikojnë nevojat dhe mundësitë për angazhimin e ekspertëve të jashtëm dhe shërbimeve të tjera publike në funksion të realizimit sa më efektiv të kurrikulës;
- Organizojnë procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve me rastin e përfundimit të shkollës dhe planifikojnë programet mbështetëse në nivel shkolle, në bashkëpunim me organet profesionale të shkollës;
- Evidentojnë në mënyrë të vazhdueshme progresin e shkollës drejt zbatimit të kurrikulës, sfidat dhe zgjidhjet e bëra në nivel shkolle;
- Udhëheqin procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe procesin e planifikimit zhvillimor të shkollës;
- Inicon dhe organizon trajnime për mësimdhënës me bazë në shkollë;
- Administrojnë procesin e shkëmbimit të përvojave ndërmjet mësimdhënësve dhe ndërmjet shkollave;
- Përkrahin organet udhëheqëse të shkollës për udhëheqje efikase të zbatimit të kurrikulës.

Pavarësisht vendndodhjes së personelit të shërbimeve profesionale, shkolla duhet të posedojë këto shërbime, respektivisht çdo shkollë në komunën përkatëse duhet të jetë e mbuluar me këto shërbime.

5. Roli i kordinatorit të cilësisë në shkollë

Koordinatori i cilësisë në shkollë është person përgjegjës për sigurimin e cilësisë në shkollë, proces i cili ndërlihet ngushtë me procesin e zbatimit të kurrikulës. Sipas UA nr. 24/2016 për Sigurimin e cilësisë në arsimin paruniversitar, kordinatorii cilësisë në shkollë:

⁵⁸ Më gjerësisht për detyrat specifike të shërbimit pedagogjik – psikologjik, shih UA n4.34/2014: Funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolladhe, Manualin për pedagog dhe psikolog te shkollave, të përgatitur me përkrahje të Programit për Arsim Themelor (BEP) të USAID-it.

- Planifikon, organizon dhe monitoron procesin e sigurimit të cilësisë së shkollës në bashkëpunim me drejtorin e shkollës,
- Ndhmon drejtorin e shkollës dhe organet qeverisëse e profesionale të shkollës në procesin e hartimit të planit zhvillimor të shkollës dhe planit të veprimit për përmirësim,
- Informon drejtorin e shkollës dhe mësimdhënësit për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë së shkollës,
- Bënë identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të mësuesve
- Së bashku me drejtorin e shkollës dhe me stafin e shkollës, kontribuon në zhvillimin e projekteve dhe proceseve për të zbatuar masat e sigurimit të cilësisë,
- Bashkëpunon me drejtorin e shkollës, dhe me stafin e shkollës, për planifikim, organizim dhe zbatimin e vetëvlerësimit të progresit në fushat e cilësisë së shkollës,
- Së bashku me stafin e shkollës, analizon dhe interpreton rezultatet e vetëvlerësimit të shkollës,
- Raporton mbi procesin e menaxhimit të cilësisë dhe rezultatet e tij tek drejtori i shkollës dhe anëtarët e stafit.
- Ndhmon në hartimin e planit për përmirësim.

6. Organet tjera profesionale të shkollës

Shkolla sipas nevojës mund të themelojë edhe organe të tjera, të përkohshme, profesionale në funksion të realizimit të aktiviteteve të ndryshme brenda veprimtarisë së saj.

P. sh.:


- Ekipi për vlerësim të brendshëm të shkollës caktohet nga shkolla për planifikimin dhe realizimin e vetëvlerësimit të shkollës,
- Ekipi për udhëheqjen e procesit të përpilimit të planit zhvillimor të shkollës,
- Ekipi për vlerësimin e arritshmërisë së nxënësve me rastin e përfundimit të shkallëve kurrikulare; etj.

Në të gjitha rastet, vendimi për themelimin e një ekipi punues duhet të përmbajë (përveç detajeve të tjera):

- listën e anëtarëve,
- përshkrimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësi,
- mënyrën e funksionimit,
- afatet për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara,
- intervalet dhe format e raportimit.

7. Hierarkia e përkrahjes, bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kurrikulës

Në skemën vijuese është paraqitur hierarkia e ndërveprimit ndërmjet organeve qeverisëse, udhëheqjes së shkollës, shërbimeve profesionale dhe kuadrit mësimor nga perspektiva e përkrahjes, bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes së procesit të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës.



Burimet:

1. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. (e rishikuar 2016). Prishtinë*
2. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë . (2012). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës (klasat 6, 7, 8 dhe 9) (e rishikuar 2016). Prishtinë*
3. MASHT dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Pakoja e tabelave për planifikimin mësimor. Prishtinë*
4. MASHT dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (për klasën parafillore dhe arsimin fillor). Prishtinë.*
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. UA nr. 08/2016, *Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës së arsimit parauniversitar në R. e Kosovës. Prishtinë.*
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. nr. 04/2012, *Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollës. Prishtinë.*
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. nr. 04/2003, *Organet qeverisëse, profesionale dhe personeli tjetër i shkollës. Prishtinë.*
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë . (2015). *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020. Prishtinë.*
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (22/2016). *UA Aktivitet Profesional (Departamentet) të shkollave. Prishtinë.*
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (23/2016). *UA Plani Zhvillimor i institucioneve të arsimit para universitar. Prishtinë.*
11. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (24/2016). *UA Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Prishtinë.*
12. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (04/2912). *UA Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollës. Prishtinë.*
13. MASHT dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. Prishtinë.*
14. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Udhëzues për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës. Prishtinë.*
15. Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës. Prishtinë.*
16. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë . (2016). *Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca (udhëzues për mësimdhënës). Prishtinë.*

Pjesa VI: Shtojcat

Shtojca 1: Planifikimi për shkallë kurrikulare - zhvillimi i kompetencave kryesore

Planifikimi për shkallë kurrikulare - zhvillimi i kompetencave kryesore				
Shembull: Shkalla 3				
Kompetencat kryesore	Praktikat mësimore për zhvillimin e kompetencave	Faktorët që mund të pengojnë zhvillimin e kompetencave	Zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e pengesave	Mësimdhënësi përgjegjës
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit				
Kompetenca e të menduarit				
Kompetenca e të mësuarit				
Kompetenca që ka të bëjë me punën, jetën dhe mjedisin				
Kompetenca personale				
Kompetenca qytetare				

Shtojca 2: Forma e planifikimit të planit dhe programit mësimor për shkallë kurrikulare

Fushat kurrikulare	Lëndët	Orët mësimore brenda viteve të shkallës përkatëse ⁵⁹		Arsyeshmëria për orë shtesë mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor	Disa orientime se si do të realizohen orët shtesë
		Kl. VI	Kl. VI		
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe				
	Gjuhë angleze				
	Gjuhë e dytë e huaj				
Artet	Edukatë figurative				
	Edukatë muzikore				
Matematika	Matematikë				
Shkencat natyrore	Lëndët e fushës				
Shoqëria dhe mjedisi	Lëndët e fushës				
Edukata fizike, sporti dhe shëndeti	Edukata fizike, dhe sporti dhe shëndeti				
Jeta dhe puna	Jeta dhe puna / Teknologji me TIK				
Gjithsej orë					

⁵⁹ Përfshihen orët mësimore të përcaktuara me plan mësimor + numri i orëve shtesë mbi minimumin e përcaktuar me plan mësimor. Numri i orëve shtesë mbi minimumin, duhet të vendoset me kujdes, në mënyrë që nxënësit të mbështeten për atë që kanë nevojë dhe të mos krijohet mbingarkesë për moshën dhe aftësitë psiko-fizike të fëmijëve/nxënësve. 93

Shtojca 3: Forma plotësuese e planit mësimor për shkallë kurrikulare

Fushat kurrikulare	Lëndët	Mësimdhënësit përgjegjës		Fondi i orëve (për lëndë)	
		Kl. VI	Kl. VII	Kl. VI	Kl. VII
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe				
	Gjuhë angleze				
	Gjuhë e dytë e huaj				
Artet	Edukatë figurative				
	Edukatë muzikore				
Matematika	Matematikë				
Shkencat natyrore	Shkenca natyrore				
Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi				
Edukata fizike, sporti dhe shëndeti	Edukata fizike, sporti dhe shëndeti				
Jeta dhe puna	Jeta dhe puna				

Shtojca 4: Forma për planifikimit vjetor

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar- Shkurt	Mars – Prill (java I)	Prill - Maj	Qershor	
Lëndët							
Lëndët							
Lëndët							

5: Forma e planifikimit dy mujor ose për një periudhë mësimore (p.sh shtator – dhjetor)

Shkalla kurrikulare:		Viti shkollor:			Periudha:		
Fusha kurrikulare:			Lënda:				
Tema/t mësimore (marrë nga plani vjetor)	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Rezultatet e të nxënit për njësi mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe situatat jetësore	Burimet dhe përgatitjet e nevojshme

Shtojca 6: Modeli 1 i Planit javor për klasë

Dita	Lëndët-njësitë mësimore							Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore ⁶⁰
E hënë	(Model i përshtatshëm për nivelin fillor dhe shkollat e vogla që kanë numer të vogël të indeksave të paraleleve në një klasë)							
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E martë	Lëndët mësimore							
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E mërkurë	Lëndët mësimore							
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E enjte	Lëndët mësimore							
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E premtë	Lëndët mësimore							
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	

⁶⁰ A) Tema të përbashkëta që orientojnë fokusin e përbashkët të gjitha lëndëve mësimore për gjatë javës, ose brenda një dite. B) Çështje ndërkurrikulare që është në fokus të javës dhe përfshihet në kuadër të shumicës së lëndëve mësimore; C) Etj,

Shtojca 7: Modeli 2 i Planit javor për klasë

Shkalla: III

Klasa: 6

Muaji: Tetor

Java: II

Fushat e kurrikulës	Lëndet mësimore	Temat /NJËSITË MËSIMORE NË JAVË /	Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare		
	Gjuhë angleze		
	Gjuhë e dytë e huaj		
Artet	Art muzikor		
	Art figurativ		
Matematikë	Matematikë		
Shkencat e natyrës	Biologji		
	Fizikë		
Shoqëria dhe mjedisi	Edukatë qytetare		
	Histori		
	Gjeografi		
Jeta dhe puna	TIK		
Ed.fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti		
Pjesa zgjedhore	Pjesa zgjedhore		
Aktivitete jashtëkurrikulare	Aktivitete jashtëkurrikulare		

Shtojca 8: Planifikimi i orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: _____ / Lënda: _____ Shkalla e kurrikulës: _____ / Klasa: _____	
Tema (nga– plani dymujor):	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore	
Fjalët kyçe	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:	
Kriteret e suksesit:	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:	
Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
VLERËSIMI I NXËNËSVE	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	

Shtojca 9: Shfrytëzimi i rezultateve të vlerësimit

p.sh. Analizë e arritshmërisë së rezultateve të vlerësimit përmbyllës

Rezultatet e performancës së nxënësve	Faktorët që kanë ndikuar performancën e nxënësve ⁶¹	Masat për përmirësim	Kush duhet të zbatoj këtë masë?	Kush duhet ta mbështes zbatimin?
<p>përshkrimi i përgjithshëm i performancës për nivelin përkatës</p> <p>p.sh. analizë e suksesit të nxënësve⁶² në vlerësimin përmbyllës</p>				

⁶¹ Faktorët duhet të elaborohen qartë dhe të jenë shumë specifik në mënyrë që të mund të planifikohen masat adekuate për eliminimin e tyre

⁶² Tabela e njëjtë mund të shfrytëzohet për analizën e suksesit të nxënësve në të gjitha nivelet, nga organet përkatëse që janë përgjegjëse për administrimin e rezultateve të vlerësimit. Shih Pjesa IV, seksioni 3.

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja "Bledi" në Prishtinë

Tirazhi: 1500 copë

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016

Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkolla / përgatitur nga Sektori për Planifikim Mësimor në Institutin Pedagogjik të Kosovës. – botimi i dytë. – Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 101 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-591-34-8



ISBN 978-9951-591-34-8



9 789951 591348